

# ARSIMI QYTETAR PËR KLASËN E 8

• UDHËZUES PËR NXËNËS •





# ARSIMI QYTETAR

## PËR KLASËN E 8

• UDHËZUES PËR NXËNËS •



Ky botim është përgatitur nga një grup punues me përfaqësues të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, Qendrës Maqedonase për Edukim Qytetar, Forumit Rinor Arsimor, si dhe profesorëve universitarë, mësimdhënësve dhe përfaqësuesve nga sektori civil, me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e botimit nuk pasqyron pikëpamjet e Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Aktivitetet për përgatitjen e përmbajtjes së botimit u realizuan në kuadër të Projektit të USAID-it për Integrimin Ndëretnik të të Rinjve në Arsim implementuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byronë e Zhvillimit të Arsimit dhe „Projektin për përforsimin e bashkëpunimit multietnik në komunat“ të Fondacionit të Fëmijëve Pestaloci.

Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar dëshirojnë të shprehin mirënjohjen e tyre për të gjithë ekspertët, bashkëpunëtorët, nxënësit, mësuesit, prindërit dhe miqtë që kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në përgatitjen e këtij Doracaku.

#### **Bashkëpunëtorët të cilët morën pjesë në zhvillimin e përmbajtjes së këtij publikimi**

Anita Angellovska, Dona Kosturanova, Tatjana Stojanoska Ivanova, Zhaneta Çonteva, Ilir Memedi, Kustrim Ahmeti, Oliver Stojanoski, Tomislav Gajtanovski, Hari Stojanovski, Sandra Anastasovska, Emilija Veteroska, Maja Cvetanovska, Loreta Georgieva, Sara Kajeviq, Ana Mickovska Raleva, Nebojsa Mojsoski, Besnik Ramadani, Dejan Rizinski, Bore Poucoski, Tulaha Tahir, Besa Reçi, Liri Starova, Xhevahire Pruthi Zajazi, Bojan Dimeski, Dragana Urumovska.

#### **Redaksia profesionale**

Mitko Çeshllarov, Ajshe Ajrullai, Gorica Mickovska, Alma Tasevska, Marko Kërtolica

#### **Titulli**

Udhëzues për nxënës për lëndën e arsimit qytetar në klasë të 8

#### **Botues**

Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ)

#### **Përktheu**

Enis Misini

#### **Disejmi**

KOMA

#### **Shtypshkronja**

Evropa 92

#### **Tirazhi**

750

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

373.3.035-057.874(036)

ARSIMI qytetar për klasën VIII : udhëzues për nxënës. - Shkup :  
Qendra Maqedonase për edukim qytetar, 2019. - 130 стр. : илустр. ; 30 см

Библиографија: стр. 126-129

ISBN 978-608-4529-75-0

a) Граѓанско образование - Ученици - Основни училишта - Водичи COBISS.MK-ID 109810186

# PËRMBAJTJE

---

<i>Tema</i>	<b>PASQYRA PËR VETEN SI QYTETAR</b> .....	<b>6</b>
<i>Tema</i>	<b>BASHKËPUNIM DHE LIDHSHMËRI NË SHOQËRINË QYTETARE</b> .....	<b>20</b>
<i>Tema</i>	<b>QYTETARI DHE SHOQËRIA</b> .....	<b>36</b>
<i>Tema</i>	<b>RELIGJIONI, ARTI DHE MEDIAT NË SHOQËRINË QYTETARE</b> .....	<b>68</b>
<i>Tema</i>	<b>QYTETARI DHE SHTETI</b> .....	<b>88</b>
<i>Tema</i>	<b>QYTETARI DHE BOTA</b> .....	<b>106</b>



# PARATHËNIE

*Nxënës të nderuar,*

Para nesh është „Udhëzuesin për nxënës për lëndën e arsimit qytetar në klasën e 8“, i cili shpresojmë do t'ju inspirojë dhe do t'u shtyjë të mendoni për ju dhe rolin tuaj në shoqëri dhe botë.

Duke lexuar udhëzuesin do të keni mundësi të niseni nga pasqyra për veten si qytetar dhe pastaj të mendoni për bashkëpunimin dhe lidhjen me qytetarët e tjerë në komunitet. Përmes përmbajtjeve do të mësoni se cilat janë të drejtat e juaja, por edhe përgjegjësitë në shoqëri dhe si mund të përfshiheni në proceset vendimmarrëse në nivel lokal dhe kombëtar. Udhëzuesi do t'ju shpie në proceset më të rëndësishme midis shtetit dhe qytetarit, por edhe lidhjet midis qytetarit dhe botës

Duke e mësuar lëndën e arsimit qytetar, pritet që ju nxënësit të bëheni qytetarë aktivë dhe të informuar të cilët kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit të tyre. Prandaj, ky udhëzues ka përmbajtje që i zmadhojnë njohuritë tuaja, por gjithashtu ofron aktivitete gjatë orëve mësimore, në shkollë dhe në bashkësinë lokale. Aktivitetet janë të krijuara që t'ju frymëzojnë të analizoni dhe të mendoni në mënyrë kritike rreth botës që ju rrethon dhe njëkohësisht t'ju inkurajonë të angazhoheni në përmirësimin e komunitetit përmes vullnetarizmit dhe aktivizmit të të rinjve. Në këtë mënyrë pritet që të zhvilloni sjellje qytetare dhe të jeni këmbëngulës në realizimin e të drejtave dhe përgjegjësisve tuaja qytetare.

Përmbajtjet e udhëzuesit do të kontribuojnë që ta përforconi frymën ekipore, bashkëpunimin dhe integrimin me moshatarët tuaj dhe së bashku të krijoni shoqëri më të mirë.

Tema

1

# PASQYRA PËR VETEN SI QYTETAR

Qëllimi  
i kësaj  
teme

është që të  
kuptohet termi  
identitet, të  
vlerësohen  
karakteristikat  
personale dhe  
të ndërlihen  
veçoritë personale  
me sjelljen në  
kontekst të  
ndryshëm qytetar.



# Çfarë është identiteti dhe **SI NDËRTOHET IDENTITETI?**

Ndërtimi i identitetit të një individi fillon që nga çasti i lindjes dhe zhvillohet përgjatë gjithë jetës. Vetëdija për veten zhvillohet që nga mosha më e re, për atë se jemi të veçantë dhe të ndryshëm, por njëherësh edhe të ngjashëm për shumë gjëra me njerëzit tjerë. Ky është fillim i procesit të ndërtimit të **identitetit personal** dhe **grupor**, i pasuar me periudha në të cilat interesat, dëshirat dhe nevojat e llojllojshme kanë rëndësi të ndryshme për individin, të cilat mëpastaj ndikojnë në mënyra të ndryshme në zhvillimin e identitetit të tij.



## Shembull:

Kur Sara ishte në klasën e pestë për të ishte shumë me rëndësi që të jetë nxënëse e shkëlqyeshme prandaj ajo kalonte shumë kohë duke mësuar. Në klasën e tetë, për të është gjithashtu e rëndësishme që të jetë e pranuar në shoqëri dhe prandaj një pjesë të kohës e kalon në komunikim dhe shoqërim. Sara dëshiron të jetë nxënëse e suksesshme, por njëherësh interesante në shoqëri dhe kjo është pjesë shumë e rëndësishme e identitetit të saj.

Disa nga **faktorët** që ndikojnë në formimin e identitetit janë të përcaktuar paraprakisht, si p.sh. gjinia, veçoritë fizike, vendlindja. Faktorët tjerë janë më dinamik dhe vetë individi dhe mjedisi mund të ndikojnë te ato, si p.sh.: vendbanimi, kultura, arsimimi, profesioni, lidhjet partnere dhe miqësore, përkatësia në grupe sociale, vlerat, interesat, etj. Sa dhe si do të ndikojnë në formimin e identitetit varet nga ajo se si ato i përjeton vetë individi dhe sa rëndësi u përkushton në situata të caktuara.

Në periudhën zhvillimore të tyre, të rinjtë janë në kërkim intensiv pas mënyrës personale të shprehjes dhe pyetja kryesore për të cilën kërkojnë përgjigje është: **KUSH JAM UNË?** Përgjigja e kësaj pyetje varet nga mjedisi dhe rolet që të rinjtë i kanë në grupet e ndryshme sociale – në familje, shkollë, në grupin e moshatarëve të tyre dhe në bashkësinë më të gjerë, etj.

**IDENTITETI PERSONAL** mbështetet në idenë se çdo individ është unik dhe i ndryshëm, gjegjësisht specifik në raport me njerëzit tjerë. Identiteti rezulton nga veçoritë e individit, si dhe marrëdhëniet me njerëzit tjerë. Më konkretisht, identiteti personal mbështetet në vlerat, idetë, emocionet, qëllimet e individit, por edhe në krahasimin me të tjerët. Ai jep ndjenjën se unë jam dikush që është i veçantë dhe i ndryshëm nga të tjerët, dhe se përkundër ndryshimeve që ndodhin gjatë jetës e përjetoj veten se jam i njëjti.

Identiteti, gjithashtu, përcaktohet edhe përmes nevojës që të jesh pjesë e ndonjë grupi ose të jesh i mbrojtur si pjesëtar i një grupi të caktuar. Të rinjtë që të kuptojnë vetveten më mirë i analizojnë ndjenjat dhe nevojat personale dhe i krahasojnë me ato të të tjerëve. Kështu e shohin se ku dhe në çfarë mënyre janë pjesë, si dallojnë dhe si lidhen me të tjerët.

Të rinjtë, me qëllim që të gjejnë pozicionin e tyre në rolet e ndryshme që i kanë (ata janë fëmijë, nxënës, fqinj, shokë, anëtarë të klubeve sportive, etj.), është me rëndësi që të zhvillojnë shkathtësi që do t'u ndihmojnë t'i bëjnë përzgjedhjet e duhura lidhur me pyetjet, siç janë: Çfarë dua për veten? Si mund ta arrij atë që e dua? Si dua të jem?

Të gjithë ne jemi pjesë e grupeve të caktuara. Disa prej tyre kanë një strukturë të caktuar dhe janë të organizuara me detyra të posaçme të anëtarëve. Këto janë grupe formale, si p.sh. klub sportiv, seksion shkollor për një lëndë të caktuar, njësi skautësh (vëzhgimi), organizatë joqeveritare, bashkësi shkollore, klub i të rinjve, etj. Gjithashtu, ekzistojnë edhe grupe joformale. Te disa prej tyre marrim pjesë me vetë lindjen tonë ose me ngjashmërinë e interesave që i kemi me të tjerët. Për shembull, grup moshatarësh, grup i adhuruesve të natyrës ose i një lloji të caktuar të muzikës, etj.



### Shembull:

Kur jemi pjesë e një grupi të tifozëve të një ekipi sportiv dhe ekipi do të pësojë humbje në ndeshje, ne jemi të pikëlluar; e kur do të fitojë – jemi krenarë dhe të lumtur.

Ndjenja e të qenit të veçantë e anëtarëve që janë pjesë e një grupi të caktuar social dhe pranimi i asaj që grupin e veçon nga të tjerët, e shënon **identitetin grupor**. Përkatësia në një grup të caktuar është e lidhur me sigurinë personale si një nga ndjenjat më të rëndësishme që na motivojnë të veprojmë. Përveç kësaj, përkatësia ndërlidhet me emocione tjera shumë të rëndësishme – me krenari, turp, kënaqësi, frikë, lumturi, pikëllim, dashuri, etj.

Aspekti emocional i identitetit tonë grupor është i rëndësishëm për shkak se paraqet bazë për sjelljen tonë dhe mirëqenien e përgjithshme.

Rëndësinë që ia atribuojmë një identiteti të caktuar grupor varet nga situata në të cilën hasemi. Kjo mund të sqarohet kështu:



### **Shembull:**

Arti është mashkull, nxënës, është 14 vjeç, është vëlla më i madh, është nga Manastiri. Se sa ndonjëri prej këtyre identiteteve për te do të jetë i rëndësishëm varet nga situata konkrete në të cilën gjendet. Në situatë kur është anëtar i kombëtares shtetërore sportive në ndeshje ndërkombëtare, ai prezantohet se është nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Nëse është në shoqëri të re në të cilën bisedohet për muzikë, ai e këmben me ata dëshirën për zhanrin rep. Kur është në shtëpi, si vëlla më i madh i ndihmon motrës së tij më të vogël rreth detyrave të shtëpisë dhe përgatitë pica të mira. Pra, cili prej identiteteve të tij grupore do t'i jetë i rëndësishëm në një situatë të caktuar dhe cilin prej tyre do ta theksojë, varet nga situata.

Kur bëhet fjalë për identitete grupore, aktuale janë diskutimet lidhur me rolet gjinore dhe formimin e identitetit gjinor. Për ta kuptuar këtë nocion, së pari duhet ta kuptojmë dallimin mes karakteristikave të seksit dhe gjinisë. Karakteristikat e seksit kanë të bëjnë me dallimet biologjike mes grave dhe burrave, derisa karakteristikat gjinore formohen gjatë rritjes dhe pjekurisë. Në jetën e përditshme, në të shumtën e rasteve prej djemve dhe vajzave pritjet të sillen në mënyrë të ndryshme nën ndikimin e mjedisit dhe pritjeve të të tjerëve.

Shoqëria u përcakton role të ndryshme burrave dhe grave në bazë të gjinisë së tyre, ndonëse pjesa më e madhe e punëve që ata i kryejnë nuk varen nga gjinia. Për shembull, në pjesën më të madhe të reklamave për mjetet e pastrimit, gratë janë paraqitur si ato që kujdesen për shtëpinë, ndonëse obligimet e shtëpisë duhet të jenë kujdes i përbashkët i të gjithë anëtarëve të familjes, pa dallim të seksit. Prandaj, burrat dhe gratë mund ta pastrojnë shtëpinë po aq mirë dhe poashtu mirë mund të ndërrojnë gomën e automobilin.

**Rolet e gjinive** kanë të bëjnë me atë se si shoqëria shikon rolin e vajzave dhe djemve, grave dhe burrave, derisa **identiteti gjinor** ka të bëjë me përjetimin personal për gjininë personale. Rolet e gjinive nuk duhet të na kufizojnë në bërjen e punëve që i duam.



### Shembull:

Garuesi më i suksesshëm në patinazh, Evgenij Plushenko nuk do të ishte aq i suksesshëm nëse do të ishte kufizuar nga mjedisi që të merret me patinazh artistik, që në të kaluarën konsiderohej si aktivitet tipik femëror. Shkencëtarja e njohur Marija Kiri Sklodovska nuk do ta merrte çmimin Nobel për fizikë dhe kimi nëse nuk do të ishte këmbëngulëse dhe e përkushtuar ndaj shkencës, edhe pse koha në të cilën ka jetuar impononte kufizime për profesionet me të cilat mund të merren gratë.

Prandaj, është shumë e rëndësishme që secili të bëjë përzgjedhjen në bazë të dëshirave, interesave dhe nevojave personale, që në shoqërinë bashkëkohore ndërton barazi gjinore si vlerë e rëndësishme qytetare.

Përkatësia në një grup të caktuar etnik, pranimi i karakteristikave të atij grupi dhe ndjenja e lidhshmërisë me të e shënon **identitetin etnik**. Identiteti etnik lidhet me përkatësinë në një grup të caktuar etnik, derisa identiteti kombëtar me ekzistimin e shtetit dhe përkatësinë në të.




### Shembull:

Në botë ekzistojnë mbi 5000 identitete etnike (p.sh. italianë, maqedonas, shqiptarë, turq, finlandez, romë, punxhabi, zulu, tutsi, kurdë, etj.) por nuk ka aq identitete kombëtare, meqë ka vetëm rreth 200 shtete.

Pjesëtarët e një grupi të caktuar etnik i lidhë historia, prejardhja, tradita, që i bën të jenë të lidhur fuqishëm mes vete. Ngjashëm me identitetin etnik është **identiteti kombëtar**. Identiteti kombëtar është pjesë e rëndësishme e identitetit grupor që rezulton nga ndjenja e përkatësisë në një shtet të caktuar, në të cilin është e mundshme të jetojnë më shumë grupe etnike.

Qytetari zhvillon ndjenjën e përkatësisë ndaj shtetit të tij, ndaj vlerave që ai i promovon dhe ndaj individëve tjerë që jetojnë në të dhe i shkëmbejnë këto vlera. Rregullimi i shtetit dhe

funkcionimi i institucioneve ndikon në ndjenjën e përkatësisë ndaj shtetit. Republika Maqedonia e Veriut është shtet që u takon të gjithëve që jetojnë në të dhe Kushtetuta ua garanton mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.





## Vallë, e keni ditur se ...

1

Psikologu Erik Erikson e ka shpikur termin „**krizë e identitetit**”. Të rinjtë, por edhe të moshuarit mund të kalojnë nëpër periudha në të cilat individit përjeton habi ose pasiguri. Për shembull, të rinjtë përballen me ndryshime në pamje, fillojnë të mendojnë më shumë për atë se kush janë në fakt, u bëhet shumë e rëndësishme se çfarë mendojnë të tjerët për ta, etj. Të gjitha këto gjëra ndikojnë në individin dhe identitetin e tij personal. Disa nga ndryshimet janë të kalueshme, e disa mund të jenë të përhershme.

2

Zakonisht shitoret e lodrave kanë raftet me lodra për „**meshkuj**” dhe „**femra**” dhe në këtë mënyrë e mbështesin mendimin se djemtë dhe vajzat kanë interesa të ndryshëm dhe duhet të përgatiten për role të ndryshme kur të bëhen të moshuar. Por, në vitin 2012, një shitore për lodra në Suedi vendosë të fillojë me kombinimin e llojeve të ndryshme të lodrave që secili fëmijë të mund ta zgjedhë atë me çka dëshiron të luajë, e jo atë që e imponon mjedisi si të përshtatshme për gjininë e tij/e saj. Që atëherë edhe shitoret tjera kanë filluar të ndjekin këtë shembull.



## Aktivitetet në orë

### Së pari mendo për pyetjen: *Kush jam unë?*, e më pas plotëso fjalitë:

- ▶ Interesat e mi kryesorë janë .....
- ▶ Vlerat e mia kryesore janë.....
- ▶ Nevojat e mia kryesore janë .....
- ▶ Ngjarjet më të rëndësishme në jetën time janë .....
- ▶ Veçoritë më të rëndësishme që kam përvetësuar nga më të afërmit janë .....
- ▶ Përvoja më e rëndësishme nga shkolla për mua është .....
- ▶ Shokët e mi më të mirë janë .....
- ▶ Pasioni im i preferuar është.....
- ▶ Kënga ime e preferuar është .....



### Më pas mendo dhe përgjigju në pyetjen si vijon:

- ➔ A e kishe të vështirë që t'i përfundosh pohimet? Pse?
- ➔ Çfarë mendon, çfarë mund të ndihmojë që të njohim vetveten dhe sa kohë është e nevojshme?
- ➔ A mendon se ndonjëra nga deklaratat e sipërpërmendura mund të ndryshohet për 5 vite prej tani? Sqaro!



### Çfarë ndikon në identitetin tim?

- ➔ Mendo për atë se cilët janë pesë faktorët kryesorë që ndikojnë në ndërtimin e identitetit tënd? Disa nga faktorët që ndikojnë në këtë proces janë: gjinia, mosha, pamja, prejardhja, familja, shëndeti, veçoritë e individit, përvoja, vlerat, qëllimet, vendimet, interesat, stili i jetës, sjellja e tjerëve ndaj teje (prindër/kujdestarë, shokë, arsimtarë, trajnerë, etj.), grupe të ndryshme sociale, etj.

# Karakteristika PERSONALE DHE GRUPORE

Njerëzit dallojnë mes vete sipas sjelljes, interesave, shijeve, shprehive, zakoneve, etj. Nuk ka dy njerëz tërësisht të njëjtë, e as që ka dy njerëz tërësisht të ndryshëm. Dallimet mes njerëzve e bëjnë botën më të pasur, interesante dhe ato njëherit ofrojnë mundësi për mësim, plotësim të ndërsjellë dhe zhvillim. Të gjithë njerëzit me kombinimin e karakteristikave të tyre, të cilat kanë të bëjnë me pamjen, aftësitë, të menduarit, bindjet, nevojat, interesat, kontribuojnë në begatimin e bashkësisë.

Kuptohet se njerëzit kanë edhe një numër të madh të ngjashmërive. Disa njerëz ndonjëse jetojnë në kushte dhe mjedise të ndryshme mund të kenë interesa dhe pasione të njëjta. Gjëja më e rëndësishme në bazë të së cilës njerëzit janë të ngjashëm janë nevojat e tyre për siguri, respekt, miqësi, dashuri, lojë, argëtim, realizim personal, etj.

Secili prej nesh ka veçori, veprime dhe sjellje që na pëlqejnë dhe që nuk na pëlqejnë. Ndonjëherë është vështirë të theksohet dhe të flitet për atë që na pëlqen te vetja dhe atë për çka krenohemi për shkak të frikës që të mos dukemi si lavdërues, e edhe për shkak të asaj se jemi të pasigurt nëse dhe si do të pranohet kjo nga mjedisi. Në procesin e rritjes mësojmë se si ta tregojmë atë që e çmojmë te vetja pa frikë dhe pasiguri.

Njerëz të ndryshëm mund t'i vlerësojnë në mënyrë të ndryshme veçoritë tona dhe kjo është normale. Ndonjëherë është me rëndësi të dimë se si na çmojnë të tjerët dhe të tentojmë të shikojmë edhe përmes „syzeve” të tyre për ta kuptuar më mirë sjelljen tonë dhe pasojat që kjo i lë mbi të tjerët.

Zakonisht zgjedhim që ta paraqesim mendimin që për ne e jep grupi i cili është më i rëndësishmi për ne, gjegjësisht që na njeh më së miri. Jo të gjithë nga mjedisi kanë mendim të njëjtë për ne, për shkak se me njerëz të ndryshëm shkëmbejmë aspektet tona të ndryshme të jetesës dhe individit. Nuk është e thënë se gjithmonë mendimi i tjerëve të përputhet me atë që ne vetë e kemi për veten, për shkak se disa aspekte të personalitetit tonë nuk u janë të njohura shumicës së njerëzve, ndërsa disa u janë të njohura vetëm njerëzve të afërt ose vetëm neve.



## Vallë, e keni ditur se ...

1

**Vetëekspresioni** është gjetje e mënyrës për të shprehur vetveten, personalitetin tonë, ndjenjat, mendimet, përmes fjalëve, muzikës, artit ose çfarëdo aktiviteti tjetër përmes të cilit do ta shprehim atë që është autentike dhe origjinale për ne.

2

Në vitin 1995 Këshilli i Evropës filloi fushatën, motoja e së cilës është „**Të gjithë të ndryshëm – të gjithë të barabartë**”. Qëllimi i kësaj fushate ishte që të shënohet 50 vjetori i përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe ta theksojë luftën kundër të gjitha formave të diskriminimit.





# Aktivite në orë

## **Aktiviteti 1:** **Çfarë më pëlqen,** **e çfarë nuk më** **pëlqen te unë?**

---

Mendo për atë se cilat janë veçoritë, interesat, shprehitë, vlerat, marrëdhëniet me njerëz, të arriturat tua që të pëlqejnë, ndërsa cilat nuk të pëlqejnë. Më pas plotësoje tabelën në faqen tjetër. Për secilën gjë të përmendur në secilin resht ndaras, vlerëso së pari a të pëlqen ty apo jo, e më pas vlerëso se si këtë e përjetojnë prindërit/kujdestarët dhe shokët e tu.

Për shembull, nëse shkruan se të pëlqen ajo që gjithmonë i ke të bëra detyrat e shtëpisë, atëherë në kolonë „Unë” e shënon me X se të pëlqen; te prindërit/kujdestarët nëse mendon se kjo u pëlqen, e shënon me X në kolonën përkatëse; te shokët nëse mendon se kjo nuk u pëlqen, e shënon me X në kolonën përkatëse (shiko shembullin në tabelë).

Më pas, me nxënësin pranë teje shkëmbeni përgjigjet. Duke i prezantuar njëri-tjetrit nga dy gjëra që ju pëlqejnë, gjegjësisht që nuk ju pëlqejnë te vetvetja, e më pas edhe një ose dy gjëra ku ka dallim në përgjigjet që i ka dhënë bashkënxënësi për veten në raport me vlerësimin e prindërve/kujdestarëve dhe shokëve.



**Tabela nr. 1.**

**Çfarë më pëlqen, e çfarë nuk më pëlqen te vetja**

VEÇORI, INTERESA, SHPREHI, VLERA, MARRËDHËNIE ME NJERËZ, TË ARRITURA...	UNË		PRINDËR/ KUJDESTARË		SHOKË	
	Më pëlqen	Nuk më pëlqen	U pëlqen	Nuk u pëlqen	U pëlqen	Nuk u pëlqen
Gjithmonë i bëj detyrat e shtëpisë	×		×			×
Kur merremi vesh me shokët, zakonisht unë i pari mbërrij në vendin e caktuar dhe më pas i pres të tjerët		×	×		×	



**Më pas përgjigju pyetjeve vijuese:**

- ➔ Çfarë ishte për ty më vështirë të shkruash – gjëra që të pëlqejnë te vetja ose që nuk të pëlqejnë? Pse?
- ➔ Sa shpesh i shfaq gjërat që të pëlqejnë te vetvetja?
- ➔ Si përballësh me gjërat që nuk të pëlqejnë te vetvetja? Sa i shfaq ato? A tenton që t’i përmirësosh ato?
- ➔ A është gjithmonë ajo që na pëlqen neve njëherësh e vlerësuar pozitivisht edhe nga të tjerët? Cilat janë arsyet për dallimet në vlerësim?

## Aktivitet 2:

### Aktivitet hulumtues: Identitete grupore

Shqyrtoje me kujdes tabelën nr. 2 – Identitete grupore. Më pas, imagjino se duhet t'i thuash dikujt se kush je duke përdorur vetëm tre prej kategorive të ofruara të identitetit që të përshkruajnë më së miri.

Pas zgjedhjes së tre kategorive, radhiti sipas rëndësisë, ashtu që me 1 e shënon kategorinë që mendon se është më e rëndësishme kur duhet të përshkruash vetveten, me 2 më pak të rëndësishme dhe me 3 më së paku të rëndësishme e kështu me radhë.

**Tabela nr. 2. Identitete grupore**

KATEGORI TË IDENTITETIT	Unë jam...	Radhiti prej 1 deri 3 sipas rëndësisë
sportist/e		
vullnetar/e		
skaut/e		
mashkull/femër		
nxënës/e		
artist/e		
gejmer/e		
djalë/vajzë/vëlla/motër/sugarë		
maqedonas/e	shqiptar/e	
turk/e	vllah/e	
serb/e	rom/e	
boshnjak/e	tjetër (plotëso).....	
nga .....	(shëno shtetin)	
nga .....	(shëno vendin, fshat/qytet)	
Njeri		



#### Më pas, krahaso përgjigjet tua me nxënësit tjerë në paralele dhe përgjigju në pyetjet vijuese:

- ➔ A e kishe të vështirë të veçosh tre kategori? Si u përcaktove për to? Pse pikërisht këto ishin të rëndësishme për ty?
- ➔ A mendon se kjo renditje mund të ndryshojë në të ardhmen?
- ➔ A dallon renditja jote në raport me nxënësit tjerë në paralele? Sqaro!



## Aktivitet në shkollë

**Organizohuni në grup** dhe me mbështetjen e arsimtarit zbatoni aktivitet në hapësirë shkolore dhe në kohë paraprakisht të dakorduar. Duhet të vendosni tre hamerë dhe tre flomasterë në vend të caktuar në shkollë. Ftoni nxënësit dhe arsimtarët tjerë të shkruajnë se si ndjehen lidhur me:

- ➔ disponimin momental (për shembull: ndjehem energjik, i lodhur, optimist, i lumtur, i pasigurt, i frikësuar, etj.);
- ➔ muzikë e preferuar;
- ➔ desert i preferuar;
- ➔ aktivitet i preferuar në shkollë;
- ➔ çfarë më bie ndërmend, kur më shkon mendja te shkolla ime?

**Qëllimi i këtij aktiviteti** është që të mësohet se në ndërtimin e identitetit ndikojnë faktorë të ndërlidhur mes vete nga jeta e përditshme, ndaj do të keni mundësi të analizoni në mënyrë kritike ndikimet në formimin e mendimeve dhe sjelljeve të dikujt.



Tema

2

# BASHKËPUNIM DHE LIDHSHMËRI NË SHOQËRINË QYTETARE

Qëllimi  
i kësaj  
teme

është që të  
kuptohen  
ngjashmëritë  
dhe dallimet mes  
njerëzve, si dhe  
përfitimet nga  
bashkëjetesa  
në shoqëri  
multikulturore.



# Ngjashmëri dhe dallime mes NJERËZVE NË SHOQËRINË QYTETARE

Karakteristikë themelore e **shoqërisë qytetare** është e drejta e të gjithë qytetarëve të marrin pjesë në jetën shoqërore. Kjo është njëra nga shtyllat themelore të demokracisë. Kjo do të thotë se secili qytetar, në mënyrë të ndryshme, (përmes votimit, asociimit në organizata civile, aktiviteteve vullnetare, etj.), mund të vendosë ose të marrë pjesë në vendimet që kontribuojnë në krijimin e kushteve për zhvillim dhe për jetë cilësore. Një karakteristikë tjetër e shoqërisë qytetare e cila, gjithashtu, konsiderohet si shumë e rëndësishme, është respektimi i parimeve themelore të lirisë, drejtësisë, barazisë, respektimi i dallimeve dhe të drejtave të të gjithë njerëzve.

Vendi ynë është shoqëri demokratike, qytetare ku jetojnë së bashku disa kultura dhe respektimi i këtyre parimeve është i garantuar me Kushtetutë, si akt më i lartë ligjorë.

Kur themi se në vendin tonë jetojnë pjesëtarë të kulturave të ndryshme, mendojmë në pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike, të bashkësive të ndryshme fetare, pjesëtarë që flasin gjuhë të ndryshme, etj. Të gjitha këto kultura janë specifike dhe janë të ngjashme, por edhe të ndryshme mes vete.

## *Çfarë duhet të dimë për kulturën?*

Me termin **kulturë** nënkuptohet mënyra e jetës së pjesëtarëve të një shoqërie të caktuar apo e grupeve të caktuara në kuadër të asaj shoqërie. Kjo do të thotë se kur themi kulturë, nuk mendojmë vetëm për muzikë, art, literaturë, etj. Kultura e përfshinë edhe mënyrën në të cilën njerëzit në një shoqëri të caktuar komunikojnë mes vete, mënyrën në të cilën vishen, çfarë dhe si ushqehen, zakonet që kanë të bëjnë me kurorëzimet ose, nga ana tjetër, jeta në familje, mënyra e kryerjes së punës, ceremonitë religjioze, po madje edhe plotësimi i kohës së lirë. Elementet e kulturës mund të jenë besime,

ide, thënie gojore dhe vlera, por edhe objekte arkitektonike (ndërtesa, monumente) simbole, vepra artistike (piktura, skulptura), ose nga ana tjetër teknologji, etj.

Themelore për çdo kulturë janë idetë që përcaktojnë se çfarë është ajo që konsiderohet si e rëndësishme, e vlefshme dhe e dëshirueshme. Këto ide abstrakte i paraqesin **vlerat** që pjesëtarët e një kulture të caktuar i kultivojnë dhe sipas të cilave udhëhiqen në sjelljen dhe veprimet e tyre në shoqërinë në të cilën jetojnë. Përderisa vlerat paraqesin ide për atë se çfarë është e drejtë ose e gabuar, **normat** paraqesin rregullat e sjelljes që i reflektojnë ose i vendosin vlerat kulturore. Vlerat dhe normat, bashkërisht e formojnë mënyrën në të cilën anëtarët e një kulture të caktuar sillen në rrethine tyre.



Në Japoni është tërësisht e pranueshme kur pinë supë atë ta thithin duke bërë zhurmë, kurse nga ana tjetër, në shumë kultura kjo konsiderohet si sjellje e pahijshme. Te ne gishti i madh i ngritur lartë tregon diçka pozitive, por në Malezi gjesti i tillë konsiderohet si shumë ofendues.

Më lartë u theksua se të gjitha kulturat dallojnë prej njëra-tjetrës, por megjithatë secila kulturë është po aq e rëndësishme. Është interesante të dihet se objekte, aktivitete ose ngjarje të njëjta në kultura të ndryshme mund të kenë kuptim të ndryshëm. Për shembull, në disa kultura ngjyra e bardhë është shenjë e lumturisë dhe kremtimit të çasteve të bukura, e në ndonjë kulturë tjetër është shenjë e pikëllimit. Shumë shpesh, dallimet kulturore dinë të jenë arsye për **konflikt** dhe kjo në të shumtën e rasteve ndodhë kur pjesëtarët e një kulture dinë shumë pak apo aspak për kulturën tjetër.

Jetojmë në një kohë kur përzierja e kulturave është e pashmangshme. Njëra prej arsyeve që kontribuon në këtë drejtim është **mobiliteti** gjithnjë e më i madh arsimor, që nënkupton arritjen e nivelit arsimor në ndonjë vend tjetër (sipas kësaj edhe në ndonjë kultur tjetër); arsyeja tjetër është mobiliteti më i madh i tregut të punës (njerëz të një shteti punojnë në një shtet tjetër); më pas liberalizimi i vizave që ofron mundësi për udhëtim nëpër botë dhe njoftim të kulturave të reja; si dhe interneti. Kur krijohen kushte për përzierjen e kulturave, në mënyrë të pashmangshme krijohet hapësirë për komunikim mes pjesëtarëve të kulturave të ndryshme. Në këtë mënyrë ata njoftohen mes vete dhe kanë mundësinë për të vërejtur se përveç dallimeve kanë edhe shumë ngjashmëri, përballen me sfida të njëjta në jetë dhe kanë nevoja dhe interesa të ngjashëm.



### **Shembull:**

Kur Denisi, i zgjedhur në një projekt për shkëmbim të nxënësve, shkoi në Gjermani ishte shumë i pikëlluar që i braktisë shokët dhe ishte shumë i brengosur se si do të përshtatet në mjedisin e ri. Ai nuk ishte i sigurt nëse do të gjejë shokë të ri meqë gjuhën gjermane e dinte shumë pak, nuk dinte shumë për kulturën e vendit dhe për interesat e njerëzve atje. Kishte frikë nëse do të pranohej fare nga moshatarët e tij. Kur filluan orët, në fillim kishte problem që të përshtatet, mirëpo ashtu siç njoftohej me nxënësit tjerë kuptoi se kanë interesa të ngjashëm – dëgjojnë muzikë të njëjtë, shikojnë filma të njëjtë, luajnë lojëra të njëjta në kompjuter. Kjo e inkurajoi Denisin që të komunikojë më lehtë me moshatarët, të shkëmbejë disa gjëra për veten, gjë që ishte kyçe në procesin e vendosjes së lidhjeve miqësore dhe njoftimit më të mirë të ndërsjellë.

Komunikimi dhe njoftimi janë pikë nismëtare për vendosjen e relacioneve pozitive mes pjesëtarëve të kulturave të ndryshme, që mbështeten në disa nga vlerat themelore për bashkëpunim siç janë sinqeriteti, transparenca, respektimi dhe kureshtja për të mësuar diçka të re. Kjo është e rëndësishme për realizimin e parimeve të shoqërisë qytetare demokratike.



## Vallë, e keni ditur se...

1

Në vitin 1950 vetëm 4 gjuhë janë folur në institucionet e Bashkimit Evropian, derisa **në vitin 2018 zyrtarisht përdoren 24 gjuhë**. Secili vend anëtar është prezantuar me gjuhën zyrtare të shtetit dhe rrjedhimisht ajo bëhet gjuhë zyrtare në Bashkimin Evropian.

2

**Vlerat themelore të Bashkimit Evropian janë:** respektimi i dinjitetit të njeriut dhe të drejtave të njeriut, liria, demokracia, barazia dhe respektimi i së drejtës. Ato janë përcaktuar dhe garantuar në mënyrë të qartë me „Kartën për të drejtat themelore“.





## Aktivitet në orë

Nga lista e vlerave që është paraqitur më poshtë, zgjidh 10 vlera që për ty janë më të rëndësishme. Nëse mendon se ndonjë vlerë personale e jotja nuk është përfshirë në listë, lirisht mund ta shtosh. Me këtë zgjedhje e përpilove listën tënde personale të vlerave. Tani nga kjo listë, zgjidh 5 vlera që për ty janë më të rëndësishme. Më pas, mendo dhe prej këtyre 5, zgjidh vetëm 3 vlera që për ty janë më të rëndësishme.

Pasi t'i zgjedhësh 3 vlerat e tua personale mendo për arsyet pse këto tria janë më të rëndësishme për ty, a e kishe vështirë ose lehtë që ta bësh përzgjedhjen. Më pas, me nxënësin pranë teje bisedoni për vlerat e zgjedhura.

Gjatë orës diskutoni me tërë klasën rreth vlerave që për ju janë të rëndësishme. Në diskutimin merr pjesë edhe arsimtari/arsimtarja juaj. Shikoni nëse lista e vlerave e përgatitur prej arsimtarit/arsimtares për veten e tij/saj është e ngjashme me tuajën ose ndoshta është tërësisht e ndryshme.

### Lista e vlerave personale:

→ PAQEDASHËSI	→ LUMTURI	→ KREATIVITET
→ PASURI	→ DASHURI	→ KURESHTJE
→ FAT	→ FAMILJE	→ SHËNDET
→ SUKSES	→ URTËSI	→ SINQERITET
→ MIQËSI	→ VËRTETËSI	→ PROFESIONALIZËM
→ FAMË	→ STATUS	→ PËRGJEGJËSI
→ FUQI	→ PRANIM	→ SIGURI
→ NDIKIM	→ GUXIM	→ OPTIMIZËM
→ DREJTËSI	→ BASHKËPUNIM	→ MOTIVIM
→ _____	→ _____	→ _____

# PËRKATËSIA në bashkësi

Që nga lindja ne i takojmë ndonjë bashkësie. Me bashkësi nënkuptohet një grup i njerëzve, që kanë diçka të përbashkët, si për shembull, karakteristika të përbashkëta (gjini, moshë, përkatësi etnike), qëllime të përbashkëta ose jetojnë në lokalitet të njëjtë gjeografik. Bashkësitë, në të shumtën e rasteve, kanë norma të vendosura dhe në bazë të atyre normave mundësohet mbijetesa e tyre.

Ashtu siç njeriu rritet dhe zhvillohet, ai bëhet pjesë dhe u takon bashkësive të ndryshme (për shembull: familje, shkollë, fakultet, organizatë në të cilën punon, lagje, komunë). Me këtë rast, është e pashmangshme që në ato bashkësi individi të ketë rolin personal dhe përmes tij të ndërtojë identitetin e tij (siç është sqaruar në shembujt nga tema 1: Pasqyra për veten si qytetar), por edhe të funksionojë në relacion me pjesëtarët tjerë të asaj bashkësie. Njerëzit në bashkësi plotësojnë, mbështesin dhe ndihmojnë njëri-tjetrin për t'i tejkaluar pengesat. Me komunikim të vazhdueshëm, mbështetje dhe përkujdesje të ndërsjellë, ata punojnë së bashku për të realizuar një qëllim të caktuar.



Klasa është një bashkësi në të cilën nxënësit kanë qëllim të njëjtë, e ai është që të përvetësojnë dituri dhe shkathtësi të reja. Megjithatë, të gjithë nxënësit e klasës përballen me sfida nga më të ndryshmet, kështu që në një klasë Ana e kupton shumë më mirë matematikën, ndërsa Samirit i shkon më mirë lënda e historisë. Nëse Ana i ndihmon Samirit në lëndën e matematikës dhe nëse Samiri i ndihmon Anës në lëndën e historisë, atëherë që të dy do të përvetësojnë materialin e panjohur dhe do të tregojnë rezultate të mira, me çka do ta realizojnë qëllimin e përbashkët.

Përveç përfitimeve që anëtarët i kanë nga bashkësia e tyre ata, gjithashtu, mund të kontribuojnë në mënyrë aktive në avancimin dhe zhvillimin e bashkësisë së tyre. Nxitja për përmirësimin e bashkësisë vjen atëherë kur individë ose grupe nuk janë të kënaqur ose nuk pajtohen me kushte, rregulla, norma ose situata të caktuara që i ka vendosur bashkësia. Në rast të tillë, ata mund të nxisin diskutim dhe të propozojnë zgjidhje për përmirësim. Për të realizuar zgjidhjet e propozuara, anëtarët e bashkësisë (për shembull, nxënësit në shkollë në kuadër të bashkësisë klasore ose shkollore, qytetarët në kuadër të lagjes ose komunës së tyre, etj.) mund të organizohen në forma më të ndryshme dhe të planifikojnë aksione konkrete. Në shoqëritë qytetare, një formë e veprimit në bashkësi është përmes vullnetarizmit.

**VULLNETARIZMI** paraqet një aktivitet që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës në bashkësi përmes përfshirjes aktive të njerëzve në jetën shoqërore. Vullnetarët e japin mundin, diturinë dhe kohën e tyre personale në aktivitete nga të cilat përvetësojnë dituri, shkathtësi dhe përvoja të reja. Ata krijojnë miqësi të reja, u ndihmojnë të tjerëve që të punojnë në qëllimet e tyre dhe kontribuojnë në përparimin e bashkësisë së tyre.

Vullnetarët mund të ndihmojnë në organizimin e ndonjë ngjarjeje, të angazhohen në organizatë që u ndihmon kafshëve, të marrin pjesë aktive në aksione për grumbullimin e veshjeve dhe ushqimit për njerëzit që kanë nevojë për to, të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme për ruajtjen e mjedisit jetësor dhe krijimin e mjedisit të pastër jetësor, të ndihmojnë në realizimin e aktiviteteve në shkollë, komunë, organizata qytetare dhe institucione tjera. Nga ana tjetër, voluntarizmi ka rol të rëndësishëm në përmirësimin e komunikimit me bashkësinë e tyre dhe ndihmon që të avancohen shkathtësitë dhe të përvetësohen përvoja që janë të domosdoshme për qytetari aktive.



## Vallë, e keni ditur se...

1

**Korpusi Paqësor (Peace Corps)** është organizatë joqeveritare amerikane, e cila është e përkushtuar ndaj paqes botërore dhe miqësisë, si dhe siguron vullnetarë në vendet nëpër botë që kanë kërkuar ndihmë. Korpusi Paqësor është themeluar në vitin 1961 nga presidenti Xhon F. Kenedi, ndërsa misionin e saj në vendin tonë e filloi në vitin 1996, me vullnetarë që ndihmojnë gjatë realizimit të mësimin në gjuhën angleze dhe zhvillimit të bashkësive lokale.

2

**Lidhja e skautëve (vëzhguesëve)** në vendin tonë është organizatë që ekziston prej vitit 1921. Misioni i tyre është përmes metodave të skautëve dhe edukimit joformal, fëmijët dhe të rinjtë të gjejnë vendin e tyre dhe të theksojnë karakterin e tyre, duke u përfshirë në mënyrë aktive në shoqëri, duke marrë vendime që e bëjnë botën vend më të mirë për jetesë. Anëtarë mund të bëhet secili banor i Republikës së Maqedonisë së Veriut që ka arritur moshën shtatë vjeçe.

3

Më shumë se një miliardë njerëz në botë janë **vullnetarë**.



## Aktivitetet në orë

Bëni një hartë të klasës tuaj. Shkruani emrat e secilit nxënës dhe të arsimtarit të lëndës arsimit qytetar. Për secilin ndaras shkruani një gjë në të cilën ai/ajo është i mirë/e mirë dhe në çfarë mënyre mund t'ju ndihmojë anëtarëve tjerë në bashkësinë tuaj klasore që të jenë më të mirë ose më të suksesshëm.

Bisedoni se çfarë do të donit të përmirësoni në klasën tuaj. Vendosni së paku 2 qëllime (për shembull: **1.** Të përmirësojmë shoqërimin dhe **2.** Të përmirësojmë suksesin shkollor të paraleles). Mendoni për mënyrën në të cilën secili prej jush mund të kontribuojë në realizimin e qëllimeve të vendosura.



# BASHKËPUNIMI DHE LIDHSHMËRIA *në bashkësi*

Sot në botë nuk ekziston ndonjë shtet në të cilin jetojnë njerëz që i takojnë vetëm një kulture ose vetëm një bashkësie. Për shembull, në territorin e vendit tonë jetojnë qytetarë të cilët janë pjesëtarë të kulturave dhe bashkësive të ndryshme etnike (maqedonas, shqiptarë, turq, romë, serbë, boshnjakë, vllahë, etj.). Ato shtete, gjegjësisht shoqëri në të cilat jetojnë së bashku pjesëtarë të kulturave të ndryshme quhen shoqëri multikulturale. **Multikultura** është ekzistimi i më shumë grupeve të ndryshme në një shoqëri, grupe me dallime racore, etnike, gjuhësore dhe dallime tjera. Shoqëria multikulturale angazhohet për njohjen e llojllojshmërisë etnike dhe kulturore dhe arritjen e barazisë shoqërore mes grupeve të ndryshme. Barazia nënkupton se secila kulturë në një shoqëri ka trajtim të barabartë, ndërsa karakteristikat kulturore të secilit grup janë të pranuar dhe respektuara si pjesë e identitetit të tyre.

Edhe pse në një shoqëri njerëzit vijnë prej bashkësive të ndryshme kulturore, ata krijojnë lidhje dhe janë të lidhur mes vete, në të shumtën e rasteve përmes institucioneve të përbashkëta siç janë shkollat, organizatat, ndërmarrjet, shoqatat, etj. Përmes formave të këtyre të lidhshmërisë ata bashkëpunojnë, komunikojnë dhe shkëmbejnë qëndrime dhe mendime. Megjithatë, për shkak të përkatësisë në grupe të ndryshme kulturore, etnike dhe religjioze, ndodhë që njerëzit të mendojnë në mënyrë të ndryshme për gjëra të caktuara.

Respektimi i dallimeve nënkupton pranimin se njerëzit e kulturave të ndryshme mund të kenë vlera, sjellje, besim dhe pikëpamje të ndryshme ndaj disa aspekteve nga realiteti, pa i vlerësuar si të mira ose të këqija. Ato mund të na jenë të afërta ose të largëta, të na pëlqejnë ose jo, por për to nuk bindemi ose diskutojmë, thjeshtë i pranojmë si diçka e re që e kemi mësuar për një kulturë konkrete. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në jetën e njeriut në një shoqëri multikulturale ku grupet e ndryshme kulturore i kultivojnë simbolet e tyre kulturore.



### Shembull:

Çarshia e Vjetër në Shkup është vend ku kultivohen simbole të ndryshme kulturore. Aty mund të gjejmë ushqim të shijshëm tradicional, zeje të vjetra, objekte kulturore-historike të ndërtuara nëpër histori (xhami, kisha, hane, hamame, bezistane). Gjithashtu, Çarshia është vend ku gjenden galeri artistike, muze, fakultete, shkolla, mbahen koncerte, shfaqje teatrore, revy mode, festivale të filmit dhe ngjashëm. Në Çarshi mund t'i dëgjoni të gjitha gjuhët që fliten në vendit tonë dhe është shembull i mirë i një bashkësie ku njerëzit komunikojnë, respektohen mes vete dhe ku kultivohen të gjitha simbolet kulturore.

Mënyra e këtyre bashkëveprimit është vetëm një prej shembujve se si mund të zhvillohet bashkëpunimi ndërmjet kulturave të ndryshme. Kontakti i drejtpërdrejt me pjesëtarët e kulturave të tjera na mundëson që t'i vërejmë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet kulturave dhe të mësojmë se pse është kjo kështu. Në këtë mënyrë ne zhvillojmë ndjenjën e **tolerancës** dhe respektimit të dallimeve si parakusht për ndërtimin e bashkëjetesës ndërmjet kulturave të ndryshme. Të qenët tolerant ndaj tjetrit do të thotë të tregohet mirëkuptim dhe kujdes ndaj atij që është ndryshe, me qëllim që të krijohet hapësirë për dialog, që është i domosdoshëm nëse duam të mësojmë diçka më tepër për njëri-tjetrin.

Por, nuk mjafton që vetëm të dallohet ekzistimi i grupeve të ndryshme në një bashkësi. Në vend se të jetojnë njëri pranë tjetrit, njerëzit duhet të jetojnë njëri me tjetrin. Për të përparuar shoqëria, është e domosdoshme që njerëzit e grupeve të ndryshme të njihen dhe kuptohen mes vete. Gjithashtu, është me rëndësi të veçantë që të gjithë pjesëtarët e kulturave të ndryshme në një shoqëri të kenë mundësi të barabarta që t'i zhvillojnë potencialet e tyre dhe t'i praktikojnë të drejtat e tyre. Kulturat duhet të respektohen meqë secila prej tyre sjellë vlerat e saj që mund të kontribuojnë dukshëm në jetesën shoqërore. Në këtë mënyrë arrihet respektim i dallimeve dhe tolerancë e ndërsjellë me ç'rast ndërtohet bashkëjetesë dhe bashkim.



## Vallë, e keni ditur se ...

1

Ministria e Arsimit dhe Shkencës **çdo vit u jep mbështetje shkollave** që të organizojnë aktivitete të përbashkëta të nxënësve të cilat nxisin bashkëpunimin mes nxënësve për avancimin e integritit ndëretnik në arsim.

2

Në „**Deklaratën për parimet e tolerancës të UNESCO-s**“ të miratuar në Asamblenë e Përgjithshme të mbajtur në vitin 1995, toleranca përkufizohet si: „Respektim, pranim dhe vlerësim i llojllojshmërisë së pasur të kulturave nga bota jonë, formave tona të shprehjes dhe mënyrave për të qenë njeri“.





# Aktivite në orë

## Aktiviteti 1:

Bisedoni me drejtorin e shkollës për atë se a ekziston Ekip për Integrim Shkollor në shkollën tuaj, që organizon aktivitete dhe iniciativa të përbashkëta me arsimtarët dhe nxënësit të cilët kanë prejardhje nga bashkësi të ndryshme etnike dhe të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore. Mësoni se kush janë anëtarët e ekipit, bëni një intervistë me ta, parashtrojuni pyetje për aktivitetet e zbatuara dhe prej informacioneve që i keni marrë përzgjidhni më të rëndësishmet dhe përgatitni një prezantim.

Secili prej jush në paralelen e tij duhet ta prezantojë punën e Ekipit për Integrim Shkollor në shkollën tuaj dhe t'i përshkruajë aktivitetet dhe iniciativat e përbashkëta që e përmirësojnë bashkëpunimin në klasë, shkollë, komunë, bashkësinë lokale dhe shoqëri.

## Aktiviteti 2:


Ndahuni në grupe dhe secili grup le të zgjedhë një shtet që do të paramendoni se do ta vizitoni. Secili grup hulumton për vendet, njerëzit, zakonet, ushqimin, gjuhën, religjionin dhe gjërat tjera interesante për atë shtet. Më pas, përgatitni një prezantim që do ta paraqesë më së miri shtetin që keni paramenduar se e keni vizituar. Mundohuni që prezantimi të jetë sa më interesant për bashkënxënësit tuaj. Më pas diskutoni së bashku se çfarë është e përbashkët për gjithë këto shtete.

## Aktiviteti 3:

Zgjidhni disa fjalë/shprehje që do të donit të mësoni se si shkruhen dhe shqiptohen në gjuhë tjera që fliten në vendin tonë (për shembull: në gjuhën maqedonase, serbe, shqipe, boshnjake, turke, etj). Fjalë të tilla mund të jenë: toleranca, bashkëjetesa, bashkimi, paqja, të drejtat, barazia, drejtësia, etj. ose shprehjet: „Mirëdita“, „Si je?“, „Si e ke emrin?“, „Faleminderit“, etj.

Bëni qese prej letre në të cilat do të shkruan një fjalë/shprehje në më shumë gjuhë të ndryshme. Organizoni aksion në të cilin do t'i shitni qeset me një çmim simbolik në shkollë ose jashtë saj. Paratë e mbledhura shfrytëzoni për furnizim me mjete mësimore ose gjëra të tjera që do të vlerësoni se nevojiten për shkollë.

Në këtë mënyrë: 1) do të mësoni fjalë/shprehje të reja që i përdorin disa nga bashkësitë etnike që jetojnë në vendin tonë, 2) do ta rrisni vetëdijen e bashkësisë për nevojën e përdorimit të materialeve që riciklohen (letër në vend të najlonit), 3) do të kontribuoni në përmirësimin e kushteve në shkollën tuaj.





Tema

3

# QYTETARI DHE SHOQËRIA

Qëllimi i kësaj teme  
është nxënësi:

- ▶ t'i analizojë vlerat e shoqërisë demokratike dhe rolin e juaj në të,
- ▶ të vlerësojë se si të drejtat e njeriut e avancojnë shoqërinë demokratike dhe si ai/ajo të angazhohet për avancimin e tyre,
- ▶ t'i dijë të drejtat e fëmijëve dhe nevojën e mbrojtjes së tyre,
- ▶ të mund të dallojë diskriminimin dhe të dijë të reagojë në mënyrë adekuate.



# Roli i qytetarit në SHOQËRI

Qytetar është njeriu me liri, të drejta dhe përgjegjësi të cilat i mundësojnë barabarësi me qytetarët tjerë dhe rol aktiv në jetën shoqërore.

Që nga koha antike qytetari është konsideruar si njeri me vlera fisnike, i plotësuar me mirësi dhe si person me arsimim dhe kulturë të gjithanëshme. Në këto vlera mbështetet qytetërimi bashkëkohor dhe ndërtohen bazat e demokracisë. Nocioni demokraci rrjedhë nga fjalët e vjetra greke „demos – popull” dhe „kratos – pushtet”, i cili mund të përkthehet si „sundim i popullit”. Me fjalë tjera, kjo paraqet sistem të rregullave të krijuara nga njerëzit, rregulla të cilat njerëzit duhet t’i respektojnë dhe t’i zbatojnë.

Parimet themelore që janë futur në bazën e demokracisë dhe të cilat sqarojnë se për se ajo është tërheqëse, janë idetë për:

- ▶ popullin si bashkësi e qytetarëve të lirë dhe të barabartë me norma të përbashkëta të jetës;
- ▶ mundëstëi të njëjta universale dhe barazi për të gjithë njerëzit.
- ▶ liritë dhe të drejtat që janë të patjetërsueshme dhe të pacenueshme, të cilat shteti është i obliguar t’i mbrojtë;
- ▶ shteti ligjorë i cili siguron moscenimin e të drejtave dhe lirive personale, si dhe krijimin e kushteve të volitshme për zhvillimin e shoqërisë demokratike.

Pikërisht nga parimet themelore dhe vlerat që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e qytetarëve, demokracia ka filluar të zhvillohet si formë e qeverisjes. Kështu, si kritere më të rëndësishme për zhvillimin e demokracisë janë: liria e shprehjes dhe shtypit; liria e besimit; liria e asociimit (shoqërim); e drejta për sigurimin e mbrojtjes para ligjit dhe e drejta për zbatimin e procedurave përkatëse dhe gjykim të drejtë.

Roli i **qytetarit** në shoqërinë qytetare përmbushet me realizimin e këtyre lirive dhe të drejtave, por të qenët qytetar do të thotë të jesh njeri i përgjegjshëm, si ndaj vetes ashtu edhe ndaj qytetarëve të tjerë. Kur shtrohet pyetja se si qytetari i përmbushë të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, zakonisht mendojmë për mënyrën se si ai i respekton rregullat dhe e përmirëson bashkësinë. Kështu, roli i qytetarit është që ai të inkuadrohet në vendimmarrje dhe njëkohësisht të kujdeset si për veten ashtu edhe për qytetarët tjerë në bashkësi.

Qytetarët me asociim, vetorganizim dhe me propozime të projekteve në fusha të ndryshme ndikojnë në pushtetin demokratik që ai të ndërmarrë aktivitete të caktuara për të mirën e të gjithëve. Ata marrin pjesë në vendimmarrje përmes votimit në zgjedhje kombëtare dhe lokale, si dhe në referendume.

Gjithmonë kur duhet të marrim ndonjë vendim, mendojmë se si do të ndikojë ky vendim te ne dhe në mjedisin tonë, ndaj për këtë arsye kemi edhe përgjegjësi të marrim vendime të drejta të cilat nuk do të jenë të dëmshme për bashkëqytetarët tanë, por përkundrazi, ato do të ndihmojnë në zhvillimin e bashkësisë.

Me vendimet e tyre, qytetarët ndikojnë çdo ditë në rrethinën e tyre, e ndryshojnë dhe e formësojnë atë. Qytetarët mund të bashkohen dhe të shfrytëzojnë të drejtën e tyre të garantuar me Kushtetutë, lirinë e asociimit dhe organizimit për realizimin e interesave dhe bindjeve ekologjike, sociale, kulturore, shkencore, humanitare, arsimore dhe sportive. Qytetarët mund të nisin një iniciativë qytetare që ndërlidhet me nevojat dhe interesat e tyre dhe t'ia parashtrojnë pushtetit lokal ose atij qendror.



### Shembull:




Në hyrjen e ndërtesës ku jeton Azra nuk ka rrugë ndihmëse për njerëz me nevoja të posaçme, ndërsa fqinjët e saj Sara dhe Damjani kanë nevojë pikërisht për një rrugë të tillë. Azra vendosë të caktojë një takim të këshillit shtëpiak për të gjetur zgjidhje. Gjatë takimit të gjithë fqinjët biseduan dhe u morën vesh që në komunë të parashtrajnë kërkesën për ndërtimin e një rruge të këtillë në hyrje të ndërtesës. Pas tre muajsh, komuna u përgjigj pozitivisht ndaj kërkesës dhe me këtë u bë e mundur që Sara, e cila lëvizë me ndihmën e karrocës, vetë të hyjë në ndërtesë, ndërsa Damjani të hyjë dhe të dalë më lehtë me karrocën të cilën e përdor për foshnjen e tij katërmuajshe.

Një prej komponentëve themelorë dhe të rëndësishëm të demokracisë është pjesëmarrja. Ekzistojnë mënyra të ndryshme në të cilat sigurohet pjesëmarrje në bashkësi. Për të rinjtë është i rëndësishëm termi pjesëmarrje rinore, që përdoret për të shënuar pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete të ndryshme, projekte, në procesin e përgatitjes së politikave rinore dhe në marrjen e vendimeve që janë të rëndësishme për ta. Për shembull, pjesëmarrje si përfshirje në ndonjë aktivitet grupor, më pas pjesëmarrje si bashkëveprim në metodat e nxënies, pjesëmarrje në debate dhe diskutime, pjesëmarrje në ndarjen e përgjegjësisive, në sjelljen e vendimeve etj.

Në **tabelën 1** është paraqitur „shkalla e pjesëmarrjes”, autor i së cilës është Roxher Hart, e cila i paraqet tetë shkallë të përfshirjes së fëmijëve dhe të rinjve. Kjo përdoret si kriter për vlerësimin për atë se sa të rinjtë janë të përfshirë në zgjidhjen e çështjeve të përbashkëta në bashkësi. Sipas tabelës së dhënë, shkalla gjegjësisht niveli më i lartë i pjesëmarrjes për një çështje është kur të rinjtë e iniciojnë çështjen, ndërkaq atë e zgjidhin bashkë me të rriturit, derisa niveli më i ulët i pjesëmarrjes së të rinjve është kur janë të ftuar të marrin pjesë në projekte, por nuk kanë informacione të mirëfillta, e as ndikim në vendimet dhe rezultatet e tyre.

**Tabela 1 Shkalla e pjesëmarrjes**

	SHKALLA	PËRSHKRIM	SHEMBULL NË SHKOLLË
PJESËMARRJE	Të rinjtë dhe të rriturit marrin vendime bashkërisht.	Të rinjtë japin ide, përgatisin aktivitete dhe i ftojnë të rriturit që t'u bashkangjiten.	Nxënësit duan të kenë parking për biçikleta para shkollës. Bëjnë partneritet me shkollën dhe organizatat për të dhënë propozim dhe të kërkojnë mjete nga komuna.
	Të rinjtë iniciojnë dhe udhëheqin.	Të rinjtë kanë ide dhe vendosin se si do të zbatohet projekti. Më të rriturit janë në dispozicion, japin mbështetje dhe besojnë në të rinjtë dhe në udhëheqjen e aktiviteteve nga ata.	Një grup i nxënësve marrin leje nga drejtori që të organizojnë aksion për ditën e ekologjisë. Nxënësit vendosin se cili do të jetë aksioni dhe porositë që do t'i dërgojnë; shkolla jep mbështetje.
	Të rriturit iniciojnë, vendimet i marrin bashkë me të rinjtë.	Të rriturit e japin idenë, por të rinjtë janë të përfshirë në vendimmarrjen, planifikimin dhe zbatimin e projektit.	Një arsimtar në shkollë i pyet nxënësit për ide për shënimin e ditës së të drejtave të njeriut. Nxënësit rekomandojnë të ketë koncert të benedive shkollore. Arsimtarët dhe nxënësit bashkë e përpilojnë dhe organizojnë ngjarjen.
	Të rriturit konsultohen me të rinjtë dhe i informojnë ata.	Të rriturit e përpilojnë dhe zbatojnë projektin, ndërsa opinioni i të rinjve pranohet gjatë zbatimit. Të rinjtë marrin informacion kthyes për opinionet e tyre.	Komuna organizon konsultime me nxënësit për të dhënë mendime për parkun në afërsi të shkollës. Ata tregojnë se çfarë duan të ndryshojë ose të ndërtohet. Komuna i informon të rinjtë se si rekomandimet e tyre kanë ndikuar në marrjen e vendimit dhe në ndryshimet në parkun.
	Të rinjtë janë emëruar, por edhe të informuar.	Të rriturit vendosin për projektin, kurse të rinjtë e kuptojnë projektin. Të rriturit e respektojnë opinionin e tyre.	Në tavolinën e rrumbullakët në shkollë ka hapësirë për dy oratorë - nxënës. Nxënësit merren vesh se cilët do të jenë përfaqësuesit dhe punojnë me të rriturit për të kuptuar se cili është roli i tyre në këtë diskutim.
MOSPJESËMARRJE	Tokenizëm.	Të rinjtë marrin role të caktuara në aktivitetet, por nuk kanë zgjedhje për atë që bëjnë ose për mënyrën e pjesëmarrjes.	Shkolla duhet të ketë përfaqësuesit e tyre në konferencë me institucione, arsimtar dhe nxënës. Arsimtari vetë zgjedhë nxënësin/nxënësen për konferencën, i/e cili/a nuk merr informacione për çfarë të përgatitet ose nuk ka kohë që të konsultohet me bashkënxënësit tjerë për mendimet e tyre.
	Dekorim.	Të rinjtë marrin rol, por në nivel të kufizuar dhe nuk kanë rol në vendimet.	Në shkollë organizohet ngjarje, që tërësisht është e përgatitur nga të rriturit. Nxënësit marrin fanella që duhet t'i mbajnë dhe tekst për recital, por nuk kanë informacion se për çfarë organizohet ngjarja.
	Manipulim.	Të rriturit kanë autoritet të plotë dhe mund ta keqpërdorin fuqinë. I përdorin idetë dhe votat e të rinjve për dobi personale.	Shkolla dëshiron të organizojë kremtimin e gjysmëmaturës në një hotel. I fton nxënësit në takim që të diskutojnë se ku duan të jetë kremtimi. Ndonëse nxënësit kanë qëndrim tjetër, shkolla mbetet në propozimin e parë dhe thotë se është marrë vesh me nxënësit.





## Vallë, e keni ditur se...

1

Sipas nenit 22 të Kushtetutës: „Çdo qytetar që ka mbushur 18 vjet fiton të drejtën e votimit. E drejta e votimit është e barabartë, e përgjithshme dhe e drejtpërdrejtë dhe realizohet në zgjedhje të lira me votim të fshehtë” (Kushtetuta e RMV-së, 2019).

2

Presidenti amerikan Xhon Kenedi në një rast ka deklaruar: „Mos pyet se çfarë mund të bëjë shteti për ty, pyete veten se çfarë mund të bësh ti për shtetin”. Me këtë deklaratë ai i ka nxitur qytetarët që të marrin pjesë aktive në përparimin e shtetit.

3

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut mund të jeni anëtar në shoqatë qytetare në moshën 14 vjeçe me lejen e prindit ose kujdestarit, ndërsa të themeloni shoqatë të qytetarëve në moshën 15 vjeçe, gjithashtu me leje të prindit ose kujdestarit.



# Aktivitetet në orë


## Aktiviteti 1:

Përkujtohuni në një ngjarje ku keni marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes (debat, aktivitet jashtë mësimor shkollor, kremtim ose ekskursion) dhe vlerësoni se cili është niveli i pjesëmarrjes rinore duke përdorur shkallën e Roxher Hartit.

Pasi që u njoftuat me nivelin e pjesëmarrjes rinore, nga perspektiva e sotme, a do të kishit ndryshuar diçka në procesin e vendimmarrjes për atë ngjarje? Nëse po, çfarë është ajo? Ndani pikëpamjen tuaj me të tjerët në klasë.


## Aktiviteti 2:

Në shkollën fillore ku mëson Maja tualetet janë në gjendje shumë të keqe. Vazhdimisht janë të papastrat dhe prej tyre përhapet erë e pakëndshme. Në tualet nuk ka sapun, shportë për mbeturina dhe letër tualeti, ndërsa edhe çezmat shpesh janë të prishura. Nxënësit u tregojnë vazhdimisht kujdestarëve të tyre të klasës se gjendja në tualetet u pengon shumë dhe se për shkak të kësaj hezitojnë që t'i përdorin. Arsimtarët u tregojnë se janë të vetëdijshëm për problemin, por nuk mund të bëjnë asgjë lidhur me këtë. Drejtorja e shkollës, nga ana tjetër, i këshillon nxënësit se ata vetë duhet të jenë më të ndërgjegjshëm kur e përdorin tualetin, ta ruajnë inventarin dhe të kenë kujdes se çfarë mbeturinash hedhin.



### Mendoni dhe diskutoni në klasë:

- ➔ Cilat janë përgjegjësitë e nxënësve, arsimtarëve, drejtorisë së shkollës?
- ➔ Si do të mund të zgjidhej problemi, ashtu që nevojat e secilës prej palëve të jenë të përmbushura?



## Aktivitet në bashkësi

- ▶ Nxënësit në çifte marrin detyrë të paraqesin ndonjë problem infrastrukturor, ekologjik ose social nga mjedisi i tyre i drejtpërdrejt (shkollë, komunë) që shqetëson ata, prindërit e tyre ose fqinjët, ndërsa konsiderojnë se do të mund të angazhoheshin për zgjidhjen e tij. Më pas grupohen në grupe me nga 5-7 nxënës. Diskutojnë në temën e njëjtë. Ata zgjedhin një problem që është më i rëndësishëm. Një përfaqësues nga çdo grup prezanton para gjithë klasës dhe hapet diskutimi në kuadr të klasës. Përzgjedhja e problemit bëhet në formë kompromisi. Propozohen mënyra për zgjidhjen e tij. Përcaktohet ekipi që do të provojë të zgjidhë problemin. Ekipi përpilon planin për aktivitete konkrete: cakton takime me ata për të cilët konsiderojnë se mund të ndihmojnë (për shembull përfaqësues të bashkësisë së nxënësve, përfaqësues të arsimtarëve, këshillit të prindërve, drejtorin e shkollës, këshillin e shkollës, kryetarin e komunës, këshillin e komunës, përfaqësuesit e sektorit ekonomik nga mjedisi i drejtpërdrejt). Ekipi i informon nxënësit tjerë për rezultatet e bisedimeve dhe bashkërisht i planifikojnë hapat e radhës. Në problemin e dhënë punojnë një periudhë më të gjatë, sipas mundësisë deri në zgjidhjen e tij ose deri në çastin kur organet kompetente marrin përsipër zgjidhjen e tij.



# ZHVILLIM

## *i të drejtave të njeriut*

Ideja për të drejtat e njeriut zanafillën e ka tek filozofët antik të cilët konsideronin se njerëzit për nga natyra janë të barabartë dhe se robëria paraqet një dukuri të panatyrshme dhe joracionale. Me këtë ndërlidhet e drejta romake, sipas të cilës të gjithë njerëzit kanë aftësinë e të menduarit. Liritë dhe të drejtat për herë të parë paraqiten në mendimin teorik të Xhon Lokut. Teoria e tij për të drejtën e natyrshme për jetë, liri dhe pronësi për herë të parë zbatohet me shkrim në shekullin XVII në Angli përmes një dokumenti që i vendosë bazat e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Më pas, në shekullin XVIII edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës krijojnë „Kartën e të drejtave“, e cila edhe sot është pjesë e Kushtetutës së SHBA-së dhe i garanton të drejtat dhe liritë e qytetarëve.

Përparim i konsiderueshëm në fushën e të drejtave të njeriut ndodhë në shekullin XVIII dhe XIX, gjegjësisht gjatë revolucioneve qytetare dhe iluminizmit si lëvizje kulturore. Revolucionet qytetare janë ngritur me parullën „Liri, barazi dhe vëllazëri“, ndërsa idetë e iluminizmit janë: dinjiteti njerëzor, drejtësia dhe barazia.

Gjatë „Revolucionit qytetar francez“ nga Kuvendi Popullor i Francës është miratuar „Deklarata për të drejtat e njeriut dhe qytetarit“ e vitit 1789 në të cilën qëndron se: „Njerëzit lindin dhe mbeten të lirë dhe të barabartë në të drejtat e tyre“. Atëherë krijohet gjenerata e parë e të drejtave të njeriut.

Mirëpo, në historinë e njerëzimit, e veçanërisht në gjysmën e parë të shekullit XX, gjegjësisht gjatë Luftës së Parë Botërore, në periudhën mes dy luftërave botërore dhe veçanërisht në Luftën e Dytë Botërore vjen deri te shkelja flagrante e të drejtave të njeriut. Këto ngjarje e nxisin bashkësinë ndërkombëtare të angazhohet dhe të përgatitë një dokument me të cilin do t'i inkurajojë njerëzit që t'i respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Nga ky angazhim i bashkësisë ndërkombëtare rezultoi „**Deklarata universale për të drejtat e njeriut**“. Deklarata paraqet shprehjen e parë globale të të drejtave themelore të njerëzve. Ajo përbëhet prej 30 neneve dhe është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në

Paris, më 10 dhjetor të vitit 1948. Të drejtat dhe liritë nga Deklarata më vonë janë përfshirë në marrëveshjet ndërkombëtare dhe rajonale, në kushtetuta dhe ligje të shteteve. Deklarata është universale për shkak se të drejtat në të u takojnë të gjithë njerëzve në botë. Të drejtat e njerëzve nuk duhet të jenë të merituar, ato nuk blihen e as nuk trashëgohen, ato u takojnë të gjithë njerëzve me vetë lindjen. Njerëzit kanë të drejtën e barabartë për to, pa marrë parasysh gjininë, moshën, racën, gjuhën, kombin, pasurinë.

Në bazë të „Deklaratës universale“, Këshilli i Evropës në konferencën e mbajtur në Romë në vitin 1950 e miratoi „**Konventën evropiane e të drejtave të njeriut**“. Secili vend nënshkrues i Konventës obligohet të vendosë mekanizma të posaçëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në bazë të „Deklaratës universale“ dhe „Konventës evropiane“. Zbatimin e Konventës në vendet nënshkruese e mbikëqyrin Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut me seli në Strasburg. Çdo person nga shtetet nënshkruese i cili konsideron se i janë rrezikuar të drejtat që i garanton Konventa Evropiane mund t’i drejtohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Vendi ynë është gjithashtu edhe nënshkrues i „Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut“.

Të drejtat e pranuar ndërkombëtarisht në „Deklaratën universale“ nuk janë përfundimtare. Mënyra bashkëkohore e jetës e imponon nevojën e zgjerimit të të drejtave. Natyra e të drejtave të njeriut është e tillë që tashmë të drejtat e dhëna nuk mund asnjëherë të shkurtohen, por vazhdimisht duhet të avancohen.



## Vallë, e keni ditur se...

1


Xhon Llok është filozof anglez i shekullit XVII dhe është mendimtari më i madh social i kohës së tij. Ai ka konsideruar se ekzistojnë **tri të drejta themelore natyrore të njeriut: e drejta e jetës** – secili ka të drejtë të jetojë pasi që të lindë; **e drejta e lirisë** – secili ka të drejtë të punojë atë që do përderisa nuk e shkel të drejtën e parë të dikujt tjetër; **e drejta e pronës** – secili ka të drejtë të posedojë atë që do ta krijojë ose do ta marrë si dhuratë përderisa është në përputhje me dy të drejtat e para.

2

Teksti i „Deklaratës universale“ është përpiluar nga **Komisioni për të drejtat e njeriut** i formuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, kryetare e të cilës ishte Elenor Ruzvelt, bashkëshortja e presidentit amerikan Frenklin Ruzvelt. Në „Komisionin për të drejtat e njeriut“ janë përfshirë diplomatë nga të gjithë pjesët e botës.

3

Në botë ekzistojnë organizata ndërkombëtare që e ndjekin gjendjen e respektimit të të drejtave të njeriut në vende të ndryshme, siç është për shembull „**Human Rights Watch**“.



## Aktivitet në orë

### Matja e „temperaturës së të drejtave të njeriut“ në shkollën time

Më poshtë ka dhjetë deklaratë që kanë të bëjnë me ty dhe shkollën tënde. Lexoje secilën fjalë dhe vlerëso/ noto se sa e përshkruan saktë ajo shkollën tënde. Gjatë të menduarit, merri parasysh edhe nxënësit, arsimtarët, shërbimin profesional (pedagog, psikolog, etj.) dhe të punësuar tjerë në shkollë (p.sh. pastrues). Mblidhi notat për të fituar rezultatin përfundimtar.

#### Shkallë e pikëve:

1	2	3	4	HC
Asnjëherë (Jo/Nuk është e saktë)	Rrallë	Shpesh	Gjithmonë (Po/Saktë)	Nuk jam i/e sigurt

Deklarata	pikë
1. Shkolla ime është vend ku ndjehem i/e mbrojtur dhe i/e sigurt.	
2. Të tjerët e respektojnë hapësirën time personale dhe gjërat që më takojnë.	
3. Unë jam i/e lirë t'i shpreh qëndrimet dhe bindjet e mia pa pasur frikë se do të jem i/e diskriminuar.	
4. Në shkollën time kam mundësinë të marrë pjesë në aktivitete kulturore dhe aty respektohen identiteti im kulturor, gjuha dhe vlerat.	
5. Shkolla ime ka rregullore dhe procedura që kanë të bëjnë me diskriminimin dhe ato i zbaton në raste të incidenteve.	
6. Kur paraqiten konflikte në shkollë, tentojmë t'i zgjidhim në mënyrë paqësore dhe me bashkëpunim.	
7. Shkolla ime i pranon nxënësit, arsimtarët, administratën dhe të punësuarit tjerë që vijnë prej bashkësive dhe kulturave të ndryshme, duke përfshirë edhe njerëzit që nuk janë lindur në këtë shtet.	
8. Në shkollën time askush nuk është i ekspozuar ndaj nënçmimit ose dënimeve.	
9. Të gjithë në shkollën time kanë mundësinë për të marrë pjesë në vendimmarrjen demokratike për përpilimin e procedurave dhe rregullave të shkollës.	
10. Në shkollën time unë e marrë përsipër përgjegjësinë për të siguruar mjedis në të cilin nuk do të ushtrohet diskriminim ndaj njerëzve.	

Mblidhi pikët që ia ke ndarë secilës pyetje për ta përlogaritur „temperaturën e përgjithshme të të drejtave të njeriut“ në shkollën tënde.


„Temperatura e përgjithshme e të drejtave të njeriut“ në shkollën time është \_\_\_\_\_ .


Temperatura më e lartë = 40 „gradë e të drejtave të njeriut“ = të drejtat e njeriut në shkollë respektohen tërësisht.

Në kuadër të klasës, krahasoni përgjigjet e pyetjeve dhe bisedoni për dallimet në vlerësim nga ana e nxënësve të ndryshëm. Mblidhni rezultatet e të gjithë nxënësve për secilën deklaratë dhe përcaktoni se cilat deklaratat janë vlerësuar me më së paku pikë. Mendoni se si do të mund të përmirësohej gjendja dhe:

1. përgatitni letër me propozime për masa dhe aktivitete, të cilën do t'ia dërgoni shërbimit profesional – ose
2. organizoni debat/diskutim me shërbimet profesionale dhe nxënësit, në të cilin do të diskutoni për masa.

Qëllimi i këtij aksioni është që ju, bashkë me bashkësinë e klasës, të propozoni aktivitete deri te shërbimet profesionale për mbrojtjen e të drejtave që shkelen më së shumti në shkollë, në bazë të dëshmive dhe hulumtimeve.





## Aktivitet në bashkësi

- **Formoni ekiye** me qëllim që të identifikoni se cilat organizata dhe institucione përfaqësohen për respektimin e të drejtave të njeriut në qytetin (shtetin) tuaj. Në kuadër të hulumtimit kërkoni në internet dhe gjeni kontakt, gjegjësisht e-mail prej së paku një organizate ose institucioni.

**1)** Identifikoni cilat të drejta të njeriut shkelen më së shumti në qytetin/shtetin tuaj, **2)** Evidentoni shembuj të zgjidhjeve të sukseshme për evitimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Pas informacioneve të marra përgatitni tekst/esej me gjatësi një faqe për atë që keni mësuar dhe prezantoni para klasës tuaj/ose tekstin vendoseni në tabelën e shpalljeve.

**Qëllimi i këtij aksioni** është që përmes hulumtimit dhe kontaktimit të institucioneve dhe organizatave përgjegjëse që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në bashkësi, të dini të përmendni shembuj konkretë në të cilët janë mbrojtur të drejtat e njeriut.



# Llojet e të DREJTAVE DHE PËRGJEGJËSIVE

Me zhvillimin e të drejtave të njeriut dhe llojlojshmërisë së tyre paraqitet edhe nevoja që ato të grupohen. Të gjitha të drejtat e njeriut pa dallim se si do t'i ndajmë ose do t'i grupojmë janë të ndërlidhura mes vete. Më e shpeshtë është ndarja sipas fushës me të cilën kanë të bëjnë, kështu që të drejtat grupohen në mënyrën vijuese:

Të drejtat qytetare dhe politike konsiderohen si „gjeneratë e parë“, të drejtat sociale, ekonomike dhe ato kulturore si „gjeneratë e dytë“ dhe të drejtat kolektive, të drejtat ekologjike dhe zhvillimore, që janë paraqitur më së voni, konsiderohen si „gjenerata e tretë“ e të drejtave.

## 1. Të drejtat qytetare dhe politike (gjenerata e parë)

Të drejtat qytetare dhe politike e sigurojnë lirinë personale dhe përfshirjen e barabartë të secilit qytetar në jetën shoqërore dhe politike.

Të drejtat qytetare u mundësojnë qytetarëve integritet, jetë dhe siguri, si dhe mbrojtje nga diskriminimi në baza të ndryshme. Këto të drejta u mundësojnë qytetarëve të mendojnë lirisht, të kenë qasje të lirë deri te informatat, të flasin lirisht dhe t'i shprehin qëndrimet e tyre, etj. Për shembull, të drejtat themelore qytetare janë: liria e të shprehurit, liria e asociimit, e drejta e barazisë para ligjit, liria e besimit, e drejta e privatësisë, etj.

Të drejtat politike kanë të bëjnë me të drejtën e vendimmarrjes dhe pjesëmarrjes në jetën politike. E drejta themelore politike është e drejta e votimit. Kjo do të thotë se secili qytetar ka të drejtë të votojë në zgjedhje për përfaqësues të qytetarëve në pushtet dhe ka të drejtë të kandidohet për ndonjë post publik.

## **2. Të drejta sociale, ekonomike dhe kulturore (gjenerata e dytë)**

Këto të drejta kanë të bëjnë me fushën e jetës dhe punës shoqërore, si dhe me nevojat themelore jetësore. Ato mbështeten në idenë e barazisë dhe qasjes së garantuar deri te përfitimet, shërbimet dhe mundësitë sociale dhe ekonomike.

Të drejtat sociale janë të nevojshme për pjesëmarrje të plotë në jetën shoqërore. Ato i përfshijnë të drejtën e arsimit dhe të drejtën e themelimit të familjes, por edhe shumë të drejta të tjera, si e drejta e pushimit, e mbrojtjes shëndetësore dhe privatësisë, si dhe e drejta e mosdiskriminimit.

Të drejtat ekonomike i përfshijnë të drejtën e punës dhe mbrojtjes nga papunësia, të drejtën e standardit përkatës jetësor dhe të drejtën e sigurimit social, shëndetësor dhe pensional.

Të drejtat kulturore kanë të bëjnë me mënyrën e jetesës në kuadër të bashkësisë kulturore. Ato e përfshijnë të drejtën e pjesëmarrjes së lirë në jetën kulturore të bashkësisë.

## **3. Të drejta kolektive, solidare dhe zhvillimore (gjenerata e tretë)**

Në themelin e këtyre të drejtave qëndron solidariteti, ato i përfshijnë të drejtat kolektive të shoqërive ose të popujve, siç janë e drejta e zhvillimit të qëndrueshëm, e drejta e paqes ose mjedisit të shëndoshë jetësor.

Në pjesën më të madhe të botës në kushtet e varfërisë ekstreme, e luftërave, e katastrofave ekologjike dhe natyrore, vie në pah se shumë pak është bërë në përparimin e respektimit të drejtave të njeriut me të cilat do të siguroheshin kushtet e nevojshme për shoqëritë. Pikërisht për këtë arsye në këto të drejta, krahas të drejtave kolektive, bëjnë pjesë edhe e drejta e vetëvendosjes, e drejta e komunikimit, e drejta e qëndrueshmërisë, e drejta e ndihmës humanitare, etj.

Lidhshmëria e lirive dhe të drejtave me përgjegjësitë dhe obligimet e njeriut dhe qytetarit paraqet kusht për ekzistimin e një shoqërie të përgjeshme demokratike. Secila bashkësi njerëzore përveç lirive dhe të drejtave të njeriut i përcakton edhe detyrat/përgjegjësitë përkatëse të tijë.

Disa shembuj të thjeshtë për raportin „e drejtë – përgjegjësi“ janë: qytetari ka të drejtë të jetë kandidat dhe të zgjedhet për përfaqësues në pushtet, por njëkohësisht ka përgjegjësi që t’i mbrojë interesat dhe të drejtat e qytetarëve që e kanë zgjedhur; qytetarët kanë të drejtën e lirisë së besimit, por edhe përgjegjësi që t’i respektojnë religjionet tjera dhe ata që nuk janë religjiozë; nxënësit kanë të drejtën e arsimit, por edhe përgjegjësi që t’i respektojnë shkollën dhe mësimdhënësit; qytetarët kanë të drejtën e protestës, por edhe përgjegjësi që të mos e pengojnë lirinë e lëvizjes së qytetarëve; qytetarët kanë të drejtën e mbrojtjes shëndetësore, por edhe përgjegjësi që ta ruajnë shëndetin e tyre; qytetarët kanë të drejtë të jetojnë në mjedis të shëndosh jetësor, por edhe përgjegjësi që ta ruajnë atë.





## Vallë, e keni ditur se...

1

Vendi i parë që i mundësoi femrës të votojë, por edhe të jetë kandidate në zgjedhje është Finlanda në vitin 1906. Përndryshe, gruaja ka votuar për herë të parë në Zelandën e Re në vitin 1893, e më pas edhe në Australi në vitin 1902. Në këto dy vende gratë vetëm kanë votuar, ndërsa nuk u është mundësuar të jenë kandidate në zgjedhje.

2

Në Austri qytetarët fitojnë të drejtën e votës në moshën 16 vjeçe.

3

Slovenia në vitin 2016 u bë vendi me Kushtetutën e së cilës garantohet e drejta e ujit të pijshëm për qytetarët.



# TË DREJTAT e fëmijës

Fëmijët, si edhe të gjithë qytetarët, kanë të drejta që duhet t'i gëzojnë çdo ditë, ndërsa të rriturit dhe shtetet janë ato që duhet t'i mbrojnë dhe t'i avancojnë të drejtat e fëmijëve.

Kujdesi i posaçëm për fëmijët është i domosdoshëm për shkak të zhvillimit të tyre, i cili kërkon kujdes të posaçëm nga aspekti emocional, social dhe fizik. Fëmijët do të përgatiten më së miri të jenë qytetarë aktiv nëse që nga moshë më e hershme i dinë dhe i praktikojnë të drejtat e tyre.

Me qëllim që të mbrohen të drejtat e fëmijëve, në vitin 1946 në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara është formuar organizata UNICEF – Fond për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara. Përveç organizatave ndërkombëtare, shumë shtete, si ky i yni, punojnë në avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes formave të ndryshme. Kështu për shembull në Norvegji në vitin 1981 është vendosur avokati i parë për fëmijë, i cili paraqet një përfaqësues të pavarur dhe të paanshëm, që propozon masa për përmirësimin e kushteve në të cilat jetojnë fëmijët. Avokati i popullit i mbron të drejtat, nevojat dhe interesat e fëmijëve, punon në drejtim të zbatimit të „Konventës për të drejtat e fëmijës“ dhe angazhohet për promovimin e saj.

Dokumenti më i famshëm që i rregullon dhe i mbron të drejtat e fëmijëve është „Konventa për të drejtat e fëmijës“ e miratuar në vitin 1989 nga Asamblea e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Pranimi i Konventës në më shumë se 190 vende ka nxitur shumë ndryshime në interes të fëmijëve. Vendi ynë e pranoi Konventën në vitin 1993 dhe që atëherë shteti ka për obligim që t'i mbrojë dhe avancojë vazhdimisht të drejtat e fëmijëve.

„Konventa për të drejtat e fëmijës“ paraqet kornizë të standardeve që nevojiten për arritjen e mirëqenies së fëmijëve, ndërsa parimet e Konventës duhet të përfshihen në ligjet e shteteve që e kanë nënshkruar atë.

Me „Konventën për të drejtat e fëmijës“ promovohet pjesëmarrja e fëmijëve në proceset e vendimmarrjes për çështje që kanë të bëjnë me pozitën e tyre në familje dhe shoqëri, në përputhje me moshën e tyre. Gjithashtu promovohen të drejtat që duhet t'i gëzojnë fëmijët, si dhe mbrojtja prej formave të ndryshme të abuzimit dhe shkeljes së të drejtave të tyre.

Llojet e të drejtave të fëmijës mund të klasifikohen në mënyrën vijuese:

**TË DREJTA TË MBIJETESËS** – e drejta e jetës, ushqimit, vendbanimit, mbrojtjes shëndetësore, etj.

**TË DREJTA TË ZHVILLIMIT** – e drejta e arsimit dhe orientimit profesional, lojës dhe rekreacionit, e drejta e pushimit, lirisë së mendimit dhe bindjes dhe e shprehjes, e drejta e besimit, qasje deri te informacionet, aktivitete kulturore, etj.

**TË DREJTA TË MBROJTJES** – nga moskujdesi dhe mospërfillja, nga eksploatimi, nga diskriminimi, nga abuzimi seksual, etj.

**TË DREJTA TË PJESËMARRJES AKTIVE** – rol aktiv i fëmijës në familje dhe bashkësi, liri e asociimit dhe tubimit paqësor t'i shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre, etj.

Në vendit tonë, në Kushtetutën dhe ligjet, rregullohet respektimi dhe avancimi i të drejtave të fëmijës. Avokati i popullit ka rolin që të tregojë, të informojë për shkeljen e të drejtave të fëmijëve dhe njëherësh të promovojë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu, edhe organet tjera shtetërore, shkollat, vetëqeverisja lokale (komunat) dhe familjet janë të obliguara drejtpërdrejt për promovimin, realizimin, praktikimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Fëmijët, nga ana tjetër, duhet të mësojnë për të drejtat e tyre, ta shprehin qëndrimin dhe mendimin e tyre, por edhe t'i realizojnë obligimet që rezultojnë nga të drejtat e tyre. Për shembull, e drejta e arsimit nënkupton përgjegjësi të nxënësve që të ndjekin mësimin dhe t'i respektojnë nxënësit tjerë, arsimtarët dhe ta ruajnë inventarin e shkollës dhe mjedisin. Obligim i prindërve/kujdestarëve është që ta mundësojnë të drejtën e arsimit, ndërsa i shtetit, që të mundësojë kushte për arsim cilësor.



## Vallë, e keni ditur se...

1

Sipas nenit 12 të „Konventës për të drejtat e fëmijës”, **secili fëmijë ka të drejtë të shprehë qëndrimin dhe mendimin e tij në jetën e përditshme.**

2

20 Nëntori shënohet si **Dita ndërkombëtare e fëmijës.**

3

**Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara (UNICEF)** ka marrë Çmimin Nobël për paqe në vitin 1965. Zyra e UNICEF-it në vendin tonë punon që nga viti 1993. UNICEF-i punon në përmirësimin e jetës së të gjithë fëmijëve në bashkëpunim me institucionet shtetërore, organizatat qytetare dhe ekspertë të shquar vendor dhe ndërkombëtar.

4

Në institucionin Avokat i Popullit në Republikën Maqedonia e Veriut ka **dikaster të posaçëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.**



# Aktivite në orë

## Aktiviteti 1:

Ndahuni në grupe. Në secilin grup në fletë ose në tablet janë paraqitur të drejtat e fëmijëve që janë përfshirë në „Konventën për të drejtat e fëmijës”. Detyra juaj është që të vizatoni dhe me gërshërë të preni një model të shtëpisë ose piramidës. Bisedoni në kuadër të grupit se cilat të drejta do të ngjiten dhe do të paraqesin themelin e shtëpisë ose piramidës, cilat të drejta do të jenë muret, e cilat do të jenë çatia ose do të vendosen në majën e piramidës.

Pas përfundimit të aktivitetit zgjidhni se kush do të prezantojë dhe tregoni:

- ➔ Si erdhët deri te zgjidhjet?
- ➔ A kishte mosmarrëveshje?
- ➔ Cilat të drejta i mësuat?
- ➔ Cilat të drejta sipas jush ishin më të rëndësishme, a ishin ato që paraqitnin themelin e shtëpiës apo çatisë?

## Aktiviteti 2:

Analizoni tekstin vijues:

Vesna është nxënëse në klasën e 8-të dhe ka dëshirë të marrë pjesë aktive në punën e bashkësisë shkollë. Ajo ka shumë ide që dëshiron t'i ndajë me shokët e saj. Në mbledhjen e përbashkët të bashkësisë së shkollës, Vesna mori fjalën me qëllim që të ndajë idenë e saj për shënimin e 20 nëntorit, „Ditës ndërkombëtare të fëmijës”. Me këtë rast një nxënës tjetër e ndërpreu gjatë fjalimit, pa e dëgjuar, me komentin se programi për shënimin e kësaj dite është përpiluar tashmë.

- ➔ Cilën të drejtë e kishte Vesna dhe cila e drejtë i është marrë?
- ➔ A keni qenë në situatë të ngjashme në shkollën/familjen/grupin tuaj të moshatarëve?

## Aktiviteti 3:


Lexoni situatat e mëposhtme, mendoni dhe diskutoni.

**SITUATA 1:** Me qëllim që të gjithë nxënësit ta gëzojnë të drejtën e sportit dhe lojës, nxënësit nga një shkollë fillore në bashkësinë e klasës vërejtën se qasja deri te terreni i tyre për lojë nuk është e mundshme për disa nxënës që lëvizin me ndihmën e karrocës. Pikërisht për këtë arsye vendosën të ndërmarrin hapa për të tejkaluar këtë problem. I dërguan letër drejtorit dhe kryetarit të komunës me kërkesë që të takohen dhe bisedojnë për problemin. Edhe drejtori edhe kryetari i komunës u pajtuan se ky problem duhet të zgjidhet dhe premtuan se secili prej tyre në fushën e tij do të ndërmarrë masa adekuate. Për më pak se një javë, një grup i punëtorëve ndërtuan pjerrësi për qasje deri te terreni për lojë.

A keni edhe ju në komunën tuaj problem të këtillë ose të ngjashëm? Jepni propozime se si do të mund ta zgjidhni problemin. Për shembull, bëni një peticion onlajn/elektronik në të cilin do të nënshkruhen përfaqësuesit e bashkësisë suaj. Më pas, peticionin dërgojeni deri tek kryetari i komunës ose deri tek shkolla.

**SITUATA 2:** Në një shkollë një nxënës refuzonte vazhdimisht të shkojë me shokët e tij në ekspozita, koncerte dhe ekskursionë. Shoku i tij e dinte se arsyeja për këtë është mungesa e mjeteve financiare. Bashkësia e shkollës në një mbledhje u mor vesh të realizojë një aksion me të cilin do të ishin siguruar mjete për shokun e tyre. Këtë aktivitet nxënësit ia treguan kujdestarit të tyre të klasës, ndërsa ky nga ana tjetër bisedoi me drejtorin e shkollës dhe me përfaqësuesit e Këshillit të Shkollës. Aktiviteti u zbatua në nivel të shkollës dhe u mbledhën mjete të mjaftueshme financiare që të gjithë fëmijët të marrin pjesë në aktivitetet e parashikuara.

- ➔ A mund të realizoni ju aksione të ngjashme? Mendoni për mënyrat në të cilat do të mund t'i realizoni.
- ➔ Mbani mend, të gjithë fëmijët duhet t'i gëzojnë të drejtat që ua ofron „Konventa për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës“.




## Aktivitetet në shkollë

Në bashkëpunim me organizatën e nxënësve bëni një anketë me qëllim që të përcaktoni se cilat të drejta në shkollën tuaj shkelen më së shumti. Në anketë përmendni disa të drejta që praktikohen në kuadër të jetës shkollore, ndërsa të anketuarit duhet ta rrethojnë të drejtën që shkelet më së shumti dhe të tregojnë shembull/shembuj të së drejtës së shkelur (nëse ndjehen të lirë të tregojnë).

Bashkë me organizatën e nxënësve bëni një përmbledhje të rezultateve dhe:

- ▶ përgatitni letër me propozime për masa dhe aktivitete, që do t'ia dërgoni shërbimit profesional – ose
- ▶ organizoni debat/diskutim me shërbimet profesionale dhe nxënësit, në të cilin do të diskutohet për masat.

Qëllimi i këtij aksioni është që ju bashkë me organizatën e nxënësve të propozoni aktivitete deri te shërbimet profesionale për mbrojtjen e të drejtave që shkelen më së shumti në shkollë, në bazë të dëshmive dhe hulumtimeve.



# STEREOTIPA, PARAGJYKIME dhe diskriminim

Në pjesën e të drejtave të njeriut mësuam se të drejtat janë universale dhe vlejnë për të gjithë. Kjo do të thotë se të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe të gjithëve u takojnë të drejtat themelore njerëzore. Por, kjo nuk do të thotë se të gjithë njerëzit janë të njëjtë. Në mesin e njerëzve ka një numër të madh të dallimeve. Ata dallojnë sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe racore, religjionit, nacionalitetit, vendbanimit, arsimit, etj.

Dallimet mes njerëzve ndonjëherë janë arsye për qëndrime dhe veprime negative, siç janë stereotipat, paragjykimet dhe diskriminimi. **Stereotipat** mund të jenë të lidhura me përkatësinë racore, etnike, religjioze dhe gjinore të dikujt, por edhe me çfarëdo përkatësie në ndonjë grup të caktuar. Për shembull, kur bazuar te disa francezë „romantikë“ do të konstatojmë se të gjithë francezët janë romantikë, atëherë krijojmë stereotip. Ose, gjithashtu bëhet fjalë për stereotip në rastet kur formojmë ose pranojmë mendimin se njerëzit më të moshuar janë rigoroz në bazë të përvojës që kemi pasur me disa të moshuar që i njohim. Shpesh ndodhë që edhe pa njohur pjesëtarët e ndonjë grupi, të formojmë stereotipa për grupin. Kështu, në bazë të këtyre stereotipave të formuara konstatojmë se grupe të tëra të njerëzve kanë njëfarë karakteristike (punë, inteligjencë të lartë, sens të mirë për humor, etj.). Megjithatë, në realitet, njerëzit janë të ndryshëm mes vete ndonëse u takojnë grupeve të njëjta.

Stereotipat nuk janë pikëpamje të sakta, për shkak se të gjithë pjesëtarëve të një grupi u jepen veçori të njëjta edhe atë në bazë të informacioneve të pakta dhe shpeshherë të pakonfirmuara. Por, përkundër asaj që nuk janë të sakta, ato vështirë ndryshohen, meqë në të shumtën e rasteve i injorojmë dhe nuk i pranojmë informacionet që i marrim, e që janë të kundërta me stereotipin tashmë të formuar.

Kur në bazë të stereotipit ndaj një grupi të caktuar formojmë qëndrim ndaj individëve që i takojnë këtij grupi, atëherë bëhet fjalë për **paragjykime**. Paragjykimet janë qëndrime të pabaza, afatgjate ndaj disa individëve të një grupi të caktuar ose ndaj grupit dhe në të shumtën e rasteve janë të gërshetuara me ndjenja të fuqishme negative. Në formimin e paragjykimeve ndikojnë shumë faktorë, si për shembull: familja, miqtë, zhvillimet historike, etj.



### Shembull:

Damiri ka dëgjuar se njerëzit nga vendet skandinave janë shumë të ftohtë dhe vështirë krijojnë miq. Një verë, farefisë të tij të cilët jetojnë në Finlandë, e ftuan të shkoj t'i vizitojë gjatë pushimit veror. Miqtë e Damirit e ngitnin duke i thënë se atje do të mërzhitet shumë dhe se nuk do të ketë me kë të shoqërohet, meqë fëmijët atje nuk janë shumë të shoqërueshëm. Kur mbërriti në Finlandë, shkoi të argëtohet në skejt-parkun lokal. Pas një kohe të caktuar një grup i të rinjve në mënyrë të drejtpërdrejt iu afruan dhe u njoftuan me të. Ditët e ardhshme Damiri i kaloi duke u shoqëruar me shokët e tij të ri, ndërsa ata e njoftuan me qytetin dhe kulturën lokale. Kur u kthye në shtëpi, menjëherë u lëvdua para shokëve se ka gjetur shokë të rinjë dhe se finlandezët nuk janë fare të ftohtë dhe joshqërues siç kishte menduar ai më parë.

Stereotipat dhe paragjykimet ndikojnë në sjelljen e individëve në shoqëri dhe meqë zakonisht janë të pasakta, paraqesin pengesë për ndërtimin e një shoqërie të përbashkët. Ato paraqesin barrierë për komunikimin normal dhe shumë shpesh janë burim i përleshjeve dhe konflikteve, veçanërisht në shoqëritë në të cilat ka kultura dhe religjione të ndryshme. Fatkeqësisht, shumë shpesh paragjykimet kontribuojnë drejt sjelljes jokorrekte dhe të pabarabartë ndaj individëve ose grupeve të tëra të njerëzve. Sjellja e këtillë quhet **diskriminim**. Diskriminimit mund t'i nënshtrohen individë ose grupe të njerëzve, ashtu që, trajtohen si më pak të vlefshëm, u shkurtohen të drejtat ose u merren mundësitë vetëm për shkak të përkatësisë ndaj ndonjë grupi. Bazë për diskriminim mund të jetë ngjyra e lëkurës gjinia, gjuha, përkatësia fetare dhe etnike, mosha, etj.

Parandalimi i diskriminimit është i domosdoshë për realizimin e të drejtave themelore të njeriut dhe është objekt i interesit të shumë organeve dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare për të cilin qëllim janë miratuar shumë dokumente

dhe rekomandime. Në vendit tonë diskriminimi është i ndaluar. Kjo është e përcaktuar qartë në nenin 9 të Kushtetutës. Gjithashtu, ekziston edhe „Ligj për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi“. Shumë organe dhe trupa, si për shembull gjykatat, punojnë në mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit. Avokati i popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe ndërmerr veprime dhe masa për parandalimin e diskriminimit, derisa nga ana tjetër „Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi“ është organ i posaçëm i cili punon në zbatimin e „Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi“.






## *Vallë, e keni ditur se...*

**1**


**Nelson Mandela, luftëtar kundër diskriminimit racor** në Republikën e Afrikës së Jugut, ka kaluar 27 vite në burg për shkak të qëndrimeve të tij. Në moshën 76 vjeçe është zgjedhur president i Republikës së Afrikës së Jugut.





# Aktivite në orë

## Aktiviteti 1:



**Lexoni katër rrëfimet e mëposhtme, mendoni dhe përgjigjuni në pyetjet që janë nën tekstet.**

Sani është nxënëse e klasës 7, ajo është shumë e shoqërueshme, por nuk ka shumë shoqe. Shoqet e klasës së saj nuk duan të shoqërohen me Sanin për shkak se prindërit e saj janë të punësuar në një ndërmarrje në të cilën pagat nuk janë të larta. Sani nuk ka para të blejë veshje të shtrenjtë.

- ➔ Çfarë ka përjetuar Sani nga vajzat me të cilat mëson? Për çfarë arsye? Çfarë do të kishte bërë nëse do të ishte në vendin e Sanit ose nëse mëson me të?

Dona është futbollistja më e mirë në shkollë. Në shkollën e saj u organizua një ngjarje sportive, ndërsa ishte parashikuar të mbahet edhe një ndeshje në futboll të vogël. Dona u gëzua që përfundimisht do të mund të marrë pjesë në ndeshjen dhe të jetë pjesë e ekipit fitimtar. Trajneri i ekipit në njërin prej ndeshjeve ftoi 5 anëtarë që ishin parashikuar të luajnë dhe prej tyre për ndeshjen i veçoi Oliverin, Dejanin, Denisin, Ilirin dhe Miron. Për Donën nuk kishte vend. – Kjo do të jetë ndeshje „e meshkujve”, tha trajneri dhe doli nga klasa.

- ➔ Me çfarë është përballuar Dona? Pse? Si është ndier Dona? Si do të kishit vepruar ju nëse do të ishit në vendin e Donës ose të trajnerit?

Besa është nënë e 2 fëmijëve dhe është në moshën 50 vjeçe. Flet gjuhën angleze dhe gjermane, e njeh shkëlqyeshëm teknologjinë kompjuterike. Është vozitëse, ndërsa gjithashtu ka mesatare të lartë nga studimet e mbaruara. Është paraqitur në një konkurs për punësim. Ajo konsideron se i plotëson të gjitha kriteret që i kërkon kompania. Në intervistë i ka marrë të gjitha karakteristikat pozitive, por është njoftuar se kompania për këtë vend të punës kërkon person më të ri. Besa nuk është pranuar në punë.

- ➔ Me çfarë është përballur Besa? Si është ndier Besa pas intervistës? Si do të kishit vepruar ju nëse do të ishit në vendin e saj, e si nëse do të ishit në vendin e punëdhënësit? A ka shkelur kompania ndonjërin prej ligjeve?

---

Një ditë në orën e fizikës Bojani i hutuar bërtiti – „Nuk i kam paratë që mi dha nëna ime për ekskursionin e radhës!” – dhe filloi të qajë. Silvana e hidhëruar iu drejtua Janes dhe i tha: „Ti i ke marrë paratë, i di unë ata si puna jote”. Jane u skuq në faqet, por nuk i tha gjë, vetëm e uli kokën. Arsimtarja e cila ishte dëshmitare e ngjarjes, tha: „Jane ktheji paratë nëse i ke marrë”, ndërsa ky u përgjigj: „Arsimtare, nuk i kam marrë unë”. Ndërkohë, Bojanit iu kujtua se një ditë më parë paratë ia kishte dhënë kujdestarit të klasës, e më pas iu drejtua bashkënxënësve: „Kërkoj ndjesë, harrova se dje e pagova ekskursionin”. Silvana nuk tha gjë, vetëm e uli kokën.

- ➔ Si e kuptoni fjalinë: „I di unë ata si puna jote”?  
Me çfarë dukurie është përballur Jane dhe si është ndier?

## Aktiviteti 2:

Lexoni pohimet në kolonën e parë dhe lidhini me llojin e diskriminimit nga kolona e dytë.

Jo, gratë nuk mund të marrin shpërblime të njëjta për suksese sportive. Burrat janë më të mirë në sport dhe janë më interesant për t'i shikuar.

Në shkollën tonë nuk kemi kushte për mësim për nxënës me karroca (qasje adekuate, pjerrësi për qasje në godinë dhe ngjashëm). Ju lutem kërkoni ndonjë shkollë tjetër në të cilën ka kushte adekuate.

Politika jonë afariste është e orientuar drejt punësimin të punëtorëve të përkatësisë sonë religjioze, më vjen keq por ju nuk i plotësoni kërkesat tona.

Kitani është paraqitur në shpallje. – Ky vend pune është parashikuar për individ më të ri, i është përgjigjur punëdhënësi.

**DISKRIMINIMI NË BAZË TË GJNISË.**

**DISKRIMINIMI NË BAZË TË MOSHËS.**

**DISKRIMINIMI NË BAZË TË PENGESAVE TRUPORE.**

**DISKRIMINIMI NË BAZË TË PËRKATËSISË RELIGJIOZE.**



*Tema*

4

# RELIGJIONI, ARTI DHE MEDIAT NË SHOQËRINË QYTETARE

Qëllimi  
i kësaj  
teme

është të  
sqarojë rolin e  
religjionit, artit  
dhe mediave  
në shoqëri.



# Religjioni NË SHOQËRI

„Deklarata për të drejtat e njeriut“ e Kombeve të Bashkuara në nenin 18 thotë: „Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit“. Kjo e drejtë përfshinë edhe lirinë e njeriut për të ndërruar religjionin ose bindjen e tij, në mënyrë individuale apo së bashku me njerëz të tjerë përmes mësimdhënies, praktikimit, mbajtjes së shërbimeve ose riteve.

Në botë ekzistojnë një numër i madh i religjioneve. Ato përmbajnë elemente të shumta që janë thelbësore për mësimin e tyre, si dhe praktika religjioze të cilat përfshijnë rituale, predikime, lutje, meditim, muzikë, art, valle, etj. Prandaj religjioni kuptohet si përmbledhje e organizuar e mendimeve (mësim, besim), ndjenjave dhe simboleve, që ndërlidhen me kuptimin e jetës.


Format e para të religjionit paraqiten që në bashkësinë e parë të njerëzve. Njerëzit gjatë periudhave të ndryshme, më pak apo më shumë, e kanë pranuar traditën religjioze në të cilën janë lindur ose edukuar, por me zhvillimin historik të njeriut dhe shoqërisë, ka ndryshuar edhe religjioni. Në periudhën mesjetare dhe në kohën e re, religjioni ka dominuar dhe një pjesë e madhe e shoqërisë shumë dukuri i ka sqaruar me ndihmën e rregullave dhe predikimeve religjioze.


Një pjesë e madhe e shteteve bashkëkohore janë laike, që do të thotë se religjioni nuk përzihet në punët e shtetit dhe anasjelltas. Republika Maqedonia e Veriut, në përputhje me Kushtetutën, është shtet laik. Megjithatë, pa marrë parasysh karakterin laik të shtetit, religjioni edhe sot, në shoqërinë bashkëkohore, ka rol të madh në jetën e qytetarëve. Prandaj është shumë e rëndësishme të zhvillohet ndjenja e mirëkuptimit dhe ngritja e vetëdijes për respektimin e religjioneve tjera, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze, si dhe respektimin e njerëzve jo religjioz në shoqëri.

Nisur nga ky aspekt, shoqëritë e sotme janë multikulturore dhe multireligjioze. Nëse duam të jetojmë dhe të bashkëpunojmë me njerëzit që kanë religjion të ndryshëm nga ne duhet t'i njohim dhe respektojmë elementet themelore të religjionit të tyre. Kjo është strategji edhe e shtetit tonë, i cili i nxitë, ndihmon dhe promovon aktivitetet e njohjes dhe respektimit të ndërsjellë të njerëzve me përkatësi të ndryshme religjioze e kulturore.

Duke i hulumtuar religjionet mund të konstatohet se ndërmjet tyre ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime të caktuara. Shoqëria qytetare i respekton të drejtat dhe liritë e njerëzve nga aspekti religjioz, me ç'rast nga qytetarët kërkon përgjegjësi për tolerancë ndaj religjionit dhe besimeve të të tjerëve. Kjo nënkupton edhe njohjen e veçorive të bashkësive të ndryshme religjioze nga rrethi i tyre, demonstrimin e shembujve të pranimit të dallimeve religjioze dhe pjesëmarrjen aktive në debate që kanë të bëjnë me rolin e religjionit në shoqëri.

Liria e përkatësisë fetare të qytetarit është njëra prej vlerave themelore që është përkufizuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ajo i garanton të drejtat e bashkësive fetare dhe grupeve religjioze, ta shprehin dhe ta praktikojnë fenë lirisht dhe publikisht, në mënyrë individuale ose së bashku me të tjerët.







## Vallë, e keni ditur se...

**1**

Ekzistojnë rreth **10 000 religjione të ndryshme** në botë.

**2**

E drejta e përkatësisë fetare është trajtuar me „**Deklaratën për të drejtat e njeriut dhe qytetarit**“ të vitit 1789.

**3**

Besimi në më shumë perëndi quhet **politeizëm**, besimi në një Zot – **monoteizëm**, mosbesimi në perëndi – **ateizëm**.


**4**

Në shtetin tonë ekziston **Komision për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze**, i cili është organ i administratës shtetërore.



## Aktivitet në orë

- ▶ Përzgjidhni dy religjione dhe hulumtoni karakteristikat e tyre themelore (simbole, libra të shenjtë, tempuj). Përpiloni prezantim dhe shkëmbeni rezultatet me nxënësit tjerë. Më pas, hapni diskutim për ngjashmëritë dhe dallimet e secilit prej religjioneve të prezantuara.
- ▶ Vizitoni ndonjë objekt fetar në rrethinën tuaj. Më pas shkëmbeni atë që e keni vërejtur gjatë vizitës.
- ▶ **Diskutim:** Roli i religjionit në shoqërinë bashkëkohore. Njohja e religjioneve të ndryshme ndikon në zvogëlimin e stereotipeve dhe paragjytimeve ndaj tyre. Pyetje për të cilat mund të diskutoni:



- Cili është roli i religjionit në shoqërinë bashkëkohore?
- Sa ju mundësoi hulumtimi i religjioneve dhe vizitat e objekteve fetare që të njoheni me religjionet e grupeve kulturore dhe etnike në shoqërinë tonë?
- Vallë, keni pasur mundësi të vëreni te vetja nëse kanë ekzistuar paragjytime dhe stereotipe lidhur me disa religjione që kultivohen në grupet kulturore në shoqërinë tonë?
- Pasi u njohët për së afërmi me disa karakteristika të religjioneve të ndryshme, vallë ka ndryshuar mendimi i juaj për ato religjione?

# Arti

## NË SHOQËRINË QYTETARE

Çdo njeri është i lidhur në njëfarë mënyre me një lloj të caktuar të artit. Në disa raste të caktuara bëhet fjalë për ndonjë pikturë që i ka pëlqyer, në një rast tjetër për kompozim muzikor që atë e ka bërë për vete, në një rast të tretë për ndonjë ndërtesë që për të ka qenë posaçërisht e bukur. Arti përmendet për çdo ditë, meqë ai është pjesë e jetës dhe mjedisit njerëzor, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për pikturë (vizatime, fotografi, grafikë digjitale, grafitë, etj.), skulpturë, arkitekturë, muzikë, literaturë, teatër, film (dokumentarë, filma të animuar, animime 3D) dhe vallëzim (tradicional, hip-hop, balet). Në shikim të parë duket lehtë të sqarohet dhe të flitet për artin dhe duket se çdo individ di shumë për artin. Por, nga aspekti i jetës në bashkësi, arti mund të jetë edhe i ndërlikuar edhe i veçantë, ndonjëherë mund edhe të shkaktojë mendime të kundërta.

Nëse mendohet nga aspekti i arsimit qytetar, pyetemi se si është i lidhur arti me të? Çfarë do të thotë arti si pjesë e shoqërisë? Cilat janë përgjegjësitë, rolet dhe të drejtat e anëtarëve të një bashkësie? Si të jesh qytetar „i mirë”? Këto pyetje çojnë drejt njohurisë se arsimit qytetar është shumë më tepër sesa të drejta dhe përgjegjësi, kjo është edhe çështje e kulturës personale dhe përzgjedhje se çfarë na pëlqen ose jo. Secili qytetar ka të drejtën e zgjedhjes për të ndjekur art të llojllojshëm filmik, art muzikor, ngjarje tradicionale dhe/ose forma tjera të artit. Shoqëria duhet të synojë që të mundësojë qytetarët të kenë mundësinë e përzgjedhjes dhe qasjes deri te llojet e ndryshme të artit dhe në këtë mënyrë t'i realizojnë të drejtat e tyre kulturore. Për shembull, secili duhet të ketë mundësinë për të ndjekur koncerte, ekspozita, shfaqje teatrore, etj.

Në mënyrë plotësuese, një pjesë e arsimit për qytetari aktive duhet t'i nxisë njerëzit e rinj që të përvetësojnë shkathtësi, dituri dhe qëndrime që do t'i përdorin për zhvillimin e bashkësisë së tyre.



### Shembull:

Artani, Jana dhe Sërgjani janë anëtarë të seksionit teatror në shkollën e tyre. Atyre gjithashtu u pengon shumë që rrugët dhe parqet shpesh janë përplot me mbeturina dhe konsiderojnë se duhet të bëjnë diçka lidhur me këtë. Për këtë problem, ata vendosën të bisedojnë me anëtarët tjerë të seksionit dhe me arsimtaren përgjegjëse për të parë nëse mundet përmes shfaqjes teatrore ta paraqesin problemin para një publiku më të madh dhe në këtë mënyrë të tërheqin vëmendjen e tyre. Të gjithë u pajtuan me idenë e parashtuar dhe për një kohë të shkurtër përpiluan një tekst të cilin e ushtruan për shfaqje. Ajo u organizua me rastin e shënimit të „Ditës së planetit Tokë” para nxënësve dhe të punësuarve në shkollë, ndërsa ftuan edhe përfaqësues të vetëqeverisjes lokale. Shfaqja ishte bashkëvepruese dhe nga shikuesit kërkonte të japin propozime se si të zgjidhet problemi me mbeturinat dhe si secili, në mënyrë individuale dhe në nivel të institucionit, mundet të kontribuojë për mjedis më të pastër jetësor. Të gjitha propozimet janë shënuar dhe më vonë janë shkëmbyer me pjesëmarrësit (drejtorja e shkollës, këshilli i arsimtarëve, bashkësia e shkollës dhe vetëqeverisja lokale) për të parë se çfarë mund të bëhet lidhur me këtë çështje. Në këtë mënyrë anëtarët e grupit teatror me iniciativë të Artanit, Janës dhe Sërgjanit e shfrytëzuan teatrin si formë artistike për të bërë të ditur një problem të caktuar në bashkësinë dhe në këtë mënyrë të ngritin vetëdijen dhe ndjenjën e përgjegjësisë së të gjithëve që mund të kontribuojnë në zgjidhjen e këtij problemi.

Artin në të shumtën e rasteve e ndërlidhin me kulturën shpirtërore, me ç’rast për artin flitet si për imagjinatë të shpirtit njerëzor. Kësisoj, artit i kushtohet vend dhe rol i posaçëm në mesin e formave të ndryshme të kulturës. Në llojet e ndryshme të artit, njeriu e gjen fushën e shprehjes së kreativitetit të tij. Arti është i rëndësishëm meqë është pjesë e

përditshmërisë, veçanërisht kur dihet se qytetar i informuar është ai që ka kapacitet për të kuptuar, vlerësuar dhe për të kritikuar në mënyrë konstruktive vepra artistike. Njëherësh qytetarëve u ofrohet mundësia për të vizituar muzeun, shfaqjen teatrore, koncertin ose ndonjë formë tjetër të artit, me këtë rast mund të zgjedhin, kritikojnë, të diskutojnë për artin, duke e respektuar si të tillë, si dhe rrugën nëpër të cilën është krijuar arti i caktuar.

Pikërisht për këtë arsye edhe arsimit qytetar e promovon rëndësinë që të rinjtë të dinë se arti dhe estetika, si dhe respektimi i formave të ndryshme të shprehjes janë pjesë e kulturës qytetare. Në traditën e bashkësive të ndryshme njerëzore, roli dhe ndikimet e artit mund të vërehen në aspektin e veshmbathjes, tek instrumentet tradicionale, në pikturë, në objekte, në muzikë, etj. Kësisoj, arti i mundëson secilit individ ta ndjejë një lidhje të fuqishme ndaj këtyre vlerave tradicionale. Krahas kësaj, secili qytetar duhet të zhvillojë mirëkuptim se zgjedhja dhe shija personale për forma të reja të shprehjes në art është pjesë e jetesës së përbashkët dhe e shkëmbimit ndërkulturor. Në këtë mënyrë hapet mundësia për t'i kuptuar diversitetet.

Në disa kultura, arti është hapësirë për shkëmbim dhe luftë për të drejtat e njeriut ku përmes veprave artistike qytetarët i shkëmbejnë emocionet dhe propozimet e tyre për përmirësimin e jetës në bashkësi, e ndonjëherë edhe i kundërvihen drejtpërdrejt padrejtësisë ndaj një grupi të caktuar në bashkësi.



### **Shembull:**

Njëra prej veprave më të njohura të Pablo Pikasos është piktura e tij „Gernika”, e cila paraqet tragjedinë e luftës dhe vuajtjet e civilëve të pafajshëm. Është pikturuar menjëherë pas bombardimit shkatërrues nazist të qytetit Gernika në Spanjë. Pas përfundimit të saj, kjo vepër është ekspozuar në mbarë botën dhe është bërë shumë e famshme. Kjo pikturë ka marrë statusin monumental të simbolit kundër luftës dhe paraqet përkujtuesë të vazhdueshme për tragjeditë e luftës.

Kur bëhet fjalë për artin në shoqërinë bashkëkohore qytetare, është me rëndësi të përkufizohen edhe kuptimet se pse për disa drejtime të caktuara artistike konsiderohet se janë shund dhe kiç. Së këndejmi, cilat drejtime do të përkufizohen si kiç dhe shund, në të shumtën e rasteve varet nga njerëzit kompetent në lëmin e artit (kritikë, artistë relevant, profesorë etj.). Megjithatë, veprat e krijuara në drejtimet e këtylla mund t'u pëlqejnë njerëzve dhe madje edhe të kenë më shumë respektues sesa kritikë. Për shembull, literaturë shund konsiderohet ndonjë libër pa vlerë letrare, ndërsa për art kiç konsiderohet një vepër që nuk ka vlerë artistike.

Arti është më shumë sesa zbatim i shkathtësive dhe diturive për të krijuar vepër artistike, ai njëherësh na mëson për zhvillimin e orientimit personal të çdo njeriu të ri ndaj artit – i mëson për rolin dhe përgjegjësinë edhe si krijues të veprave artistike, por edhe si dashamir të disa drejtimeve të caktuara artistike. Arti ofron udhërrëfyes dhe hyrje të të rinjve drejt njërës prej aspekteve shumë të rëndësishme nga jeta kulturore.





## Vallë, e keni ditur se...

1


Në shpellën Altamira në Spanjë janë gjetur vizatime të vjetra më shumë se 36 000 vite. Këto vizatime edhe sot konsiderohen si vepra kulmore artistike të gjenialitetit kreativ dhe shembuj të veprës më të hershme artistike që nga ekzistimi i njerëzimit. Vizatimet janë edhe dëshmi e traditës kulturore dhe të arriturës së rëndësishme në historinë dhe jetën e njerëzve në atë kohë ku përmes vizatimit mësohet për dukuri të llojllojshme shoqërore.

2

Drejtimi muzikor xhaz është krijuar për shkak se një numër i madh i kulturave të ndryshme kanë jetuar, krijuar dhe janë frymëzuar prej njëri-tjetrit në një hapësirë të njëjtë, gjegjësisht në qytetin Nju Orleans. Historia e pazakonshme e qytetit, pikëpamja unike për jetën, diversiteti etnik dhe kulturor dhe bashkëveprimi kulturor kanë kontribuar në zhvillimin e këtij zhanri muzikor. Në shtetin tonë çdo vjeshtë organizohet ngjarja e dalluar Xhaz Festivali i Shkupit.


3


Artisti më i famshëm rrugor në botë Benksi përmes veprave të tij shpreh kritika ndaj dukurive shoqërore, si ngrohja globale, kapitalizmi, kriza e refugjatëve, etj.



## Aktivitetet në orë

- ▶ Përgatitje e prezantimit për artin si formë e shprehjes në tema me interes për qytetarët: mjedis i pastër, kremtim i ditës së paqes, të drejtat e kafshëve, etj.
- ▶ Diskutim për hip-hop dhe nëse ky drejtim në muzikë ndikon te rinia (mund të organizoni shfaqje për prindërit ku do të prezantohet ky drejtim përmes valles).
- ▶ Përmes projekteve hulumtuese për artet tradicionale mësojmë se si të rinjtë mund të hulumtojnë bashkë gjatë mësimit nga lënda arsim qytetar.
- ▶ Përgatitje e projekteve për zhvillim kulturor të bashkësisë dhe si mund të organizohet ngjarje kulturore për mbështetjen e artistëve autodidaktë.





## **Aktivitete në bashkësi**

### **Ekspozitë në shkollë**

- ▶ Para përfundimit të vitit shkollor mund të organizoni një ekspozitë artistike të veprave tuaja në shkollë. Bashkë me arsimtarin bisedoni dhe merrni vesh për temën e ekspozitës. Tema mund të jetë: „Qyteti im“, „Art rrugor“, „Mjedis jetësor“, „Arkitekturë rreth nesh“, „Hapësira publike“, etj. Pasi të merreni vesh për temën, mendoni për veprën ose projektin individual apo grupor që do ta kishe/it realizuar në atë temë përmes fotografisë, pikturës, skulpturës ose ndonjë formë tjetër. Merrni vesh për kohën e nevojshme për krijimin e veprave (për shembull, një javë). Kur do të jeni gati, së bashku me mësimitdhënësin vendosini veprat në ndonjë vend në shkollë për të cilin jeni marrë vesh. Si ngjarje finale mund të organizohet hapje e ekspozitës në të cilën do të jenë të ftuar bashkënxënësit tjerë për ta shikuar atë.

### **Murale në hapësira publike**

- ▶ Përzgjidhni së bashku hapësirën në të cilën do të kishit dashur të vizatoni një mural, por edhe si dëshironi të duket ai. Murali mund të përmbajë pikturë, tekst dhe elemente tjera. Për përdorimin e hapësirës publike për vizatimin e muralit duhet të dërgoni kërkesë për leje në komunë ose shkollë, varësisht se ku gjendet hapësira. Më pas përpiloni një skicë të muralit dhe bashkë me arsimtarin e artit figurativ bëni një listë të materialeve të nevojshme.

# Mediat NË SHOQËRINË QYTETARE

Sot me të drejtë mund të thuhet se jetojmë në një epokë të globalizimit, digjitalizimit masiv dhe bumit informativ. Me një shtypje të butonit të kompjuterit ose celularit menjëherë mund të merret informacion për çfarëdo gjëje dhe për këtë arsye themi se jetojmë në kohën e mediave, komunikimeve masive dhe teknologjisë bashkëkohore. Nëse shekulli XX ishte i njohur si shekull në të cilin në mënyrë periodike krijoheshin dhe zhvilloheshin mediat, shekulli XXI është shekull në të cilin mediat kanë rëndësinë më të madhe në shoqëri, veçanërisht kur bëhet fjalë për shpejtësi të informacionit dhe informacion me kohë.

Media është një kanal përmes të cilit qarkullojnë informacionet. Me nocionin „media“ nënkuptohen mjete të ndryshme për komunikim: televizion, radio, internet, media sociale, gazeta, revista dhe media tjera. Njëra prej karakteristikave të mediave është transmetimi i organizuar dhe publik i porosive, që prekin një numër të madh të njerëzve. Për shkak të kësaj, ato kanë ndikim të madh, gjë që mund të jetë edhe pozitive edhe negative.



Në vitin 1930 qytetarët u kanë besuar shumë informacioneve të emetuara në radiostacionet. Kështu, kur në vitin 1938 në një radio në SHBA është emetuar radio-program në bazë të romanit „Luftë e botëve“ nga H. G. Vells, një pjesë e dëgjuesve kanë menduar se në Tokë me të vërtetë ndodhë invadim nga jashtëtokësorët dhe në panik kanë filluar të ikin prej shtëpive. Kjo ka zgjatur derisa nuk kanë kuptuar se nuk bëhet fjalë për transmetim të lajmit, por për dramatizim të romanit.

Megjithatë, mediat mund të shërbejnë edhe për arritjen e qëllimeve fisnike. Në kohë të sotme shumë iniciativa për përmirësimin e jetës, që kanë filluar në mediat sociale në një shtet, për një kohë të shkurtër bëhen globale. Në këtë mënyrë idetë pozitive përhapen shpejtë dhe japin rezultate.



### **Shembull:**

Përmes rrjeteve sociale siç është Facebook-u informacioni për një iniciativë të caktuar përhapet shumë shpejtë deri te shfrytëzuesit, e me këtë edhe deri te opinioni më i gjerë. Në këtë mënyrë, popullata mundet për një kohë shumë të shkurtër të mobilizohet në grumbullimin e ndihmës në kushte të fatkeqësive elementare dhe situatave të ndryshme të krizës në shoqëri.

Mediat masive (mas-media) janë një nga fenomenet më të rëndësishme në shoqërinë qytetare dhe janë të pranishme në të gjitha fushat e jetës së njeriut. Roli i tyre kryesor është informimi i qytetarëve, formimi dhe krijimi i mendimit publik. Me zhvillimin e shoqërisë qytetare është gjithnjë e më i rëndësishëm funksioni dhe përgjegjësia e tyre në shoqërinë. Mediat e ndjekin punën e institucioneve dhe informojnë për të, e mbështesin lirinë e shprehjes dhe fjalës, krijojnë hapësirë për debat, promovojnë vlera demokratike, mbështetin llojlojshmërinë në mendimet dhe pjesëmarrjen qytetare në shoqëri. Për t'i arritur këto qëllime, mediat duhet t'i respektojnë parimet në punën e tyre siç janë: saktësia, vërtetësia, paanshmëria, transparenca, drejtësia, mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve.

Interneti si medium mundëson që secili shfrytëzues të publikojë përmbajtjen e tij dhe të komunikojë me secilin shfrytëzues ose media në internet. Ky shkëmbim i informacioneve në të shumtën e rasteve bëhet përmes mediave sociale ose rrjeteve sociale. Rrjetet sociale paraqesin forma të komunikimit elektronik (si ueb-faqe për komunikim social) përmes të cilave shfrytëzuesit krijojnë bashkësi „onlajn“ për shkëmbimin e informacioneve, ideve, porosive personale dhe përmbajtjeve tjera multimediale.

Ndonëse informimi përmes rrjeteve sociale është në rritje, duhet të dimë se kjo nuk mund të jetë zëvendësim për mediat dhe punën e gazetarëve. Mediat punojnë sipas rregullave të parashikuara në ligjet e vendit, dokumenteve politike dhe dokumenteve dhe standardeve ndërkombëtare. Gazetarët kanë kujdes që të jenë etik në punën e tyre, të respektojnë të drejtën e opinionit për të ardhur deri te e vërteta, të informojnë në përputhje me faktet.

Me internetin ajo që është lokale mund të bëhet globale, rritet qasja deri te një numër i madh i informacioneve, ka mundësi për komunikim me çdo pjesë të botës, mundësi që secili të ndajë informacion dhe të informojë. Megjithatë, interneti ka edhe karakteristikat e tij negative, si publikimi i lehtë i dezinformative dhe lajmeve të pavërteta, vjedhja dhe keqpërdorimi i të dhënave personale, shqetësim dhe maltretim në internet (sajber buling), gjuha e urrejtjes në internet dhe dukuri tjera. Për shkak të një pjese të dukurive të këtilla, fëmijët duhet të kenë veçanërisht kujdes për sigurinë në internet dhe nëse mendojnë se i kanë të rrezikuara të drejtat e tyre duhet t'u drejtohen prindërve ose kujdestarëve të tyre, arsimtarëve ose institucioneve si Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ose Avokatit të Popullit.

Për shkak të numrit të madh të përmbajtjeve mediatike në kohë të sotme, pranuesi i informacionit – gjegjësisht ne vetë, duhet të kemi parasysh se jo çdo informacion që plasohet në media është i vërtetë dhe i saktë. Prandaj nuk duhet të besojmë plotësisht në gjithçka, por duhet t'i kontrollojmë informacionet. Kur ne vetë shkëmbejmë ndonjë informacion që nuk është i vërtetë, marrim pjesë në dezinformimin e opinionit, prandaj për shkak të kësaj kemi përgjegjësinë që t'i kontrollojmë informacionet që të mbrojmë veten dhe të tjerët prej manipulimeve, dezinformative dhe propagandës.



## Vallë, e keni ditur se...

1

A e keni ditur se ekziston **organizatë ndërkombëtare Reporterë pa kufij** që i ndjekë liritë e mediave në gjithë botën dhe çdo vit publikon raport dhe renditje të vendeve të botës, sipas lirisë së mediave.

2


**Interneti për herë të parë** ka qenë i kapshëm si shërbim komercial **në vitin 1989**. Ndërsa rrjeti social **Facebook** paraqitet madje 15 vite më vonë **në vitin 2004**.






## *Aktivitet në orë*

- ▶ Zgjidhni ndonjë temë vendore që është aktuale atë ditë dhe më pas kërkoni disa tekste nga mediat e shtypura ditore ose ueb-mediat. Tentoni të gjeni dy ose më shumë lajme që e përpunojnë informacionin në mënyrë të ndryshme. Diskutoni se cilat janë dallimet mes lajmeve. Më pas diskutoni se cilat informacione janë të rëndësishme për ju, që të keni besim në vërtetësinë e lajmit.





## *Aktivitet në bashkësi*

### *Përpilimi i gazetës shkollore*

---

Përpiloni gazetën tuaj në të cilën do të përfshini tema që janë të rëndësishme për ju. Përmes punës praktike dhe përpilimit të gazetës do të mësoni se pse janë të rëndësishme mediat dhe si ndikojnë informacionet e transmetuara në to në qëndrimet dhe sjelljet e shfrytëzuesve. Më e rëndësishme është që informacionet të jenë të sakta, të kontrolluara dhe objektive – gazetatat nuk duhet të shkruajnë supozime ose informacione të pavërteta.

Ndahuni në disa grupe që së bashku do të shkruajnë përmbajtje dhe do ta rregullojnë gazetën. Merruni vesh që secili grup të ketë detyrë të ndryshme: intervistë, anketë, hulumtim, fotografim ose përpunim të ballinës ose pamjes grafike të faqeve. Përmbajtjet që mund t'i bëni janë: anketë shkollore (p.sh. çfarë konsideroni se është mirë ose çfarë duhet të ndryshojë në shkollën tuaj, cili arsimtar shfrytëzon metoda interesante të mbajtjes së mësimit dhe kënaqeni në ato orë), intervistë me ndonjë nxënës që ka realizuar sukses nga ndonjë lëndë ose garë, intervistë me psikolog të shkollës, tekst për probleme në shkollë (mungesë e sapunit në tualet, banka të thyera, etj.), por edhe për gjërat e mira që ndodhin (festa shkollore, sukcesi i shkollës në gara dhe risi të ngjashme). Gazeta mund të rregullohet në mënyrë elektronike në një aplikacion të thjeshtë si Microsoft Word, ku ekzistojnë shembuj për përmbajtje të këtilla, që më pas mund të shtypet ose të publikohet në ueb-faqen e shkollës.



Tema

5

# QYTETARI DHE SHTETI

Qëllimi  
i kësaj  
teme

është të mësohet  
se çfarë është  
shteti, si është  
organizuar pushteti  
në vendit tonë dhe  
cilat janë mundësitë  
e qytetarëve për  
pjesëmarrje aktive  
në shoqëri.



# Shoqëri dhe SHTET

Njeriu nga natyra është qenie sociale. Njëra prej nevojave të tij të lindura është të krijojë marrëdhënie ndërnjerëzore me qenie tjera njerëzore – të komunikojë, të bashkëpunojë, të diskutojë. Që në të kaluarën e largët njerëzit kanë kuptuar se janë të varur mes vete dhe se kur ekziston bashkëpunimi mes tyre, ata mund të lehtësojnë përditshmërinë dhe të sigurojnë mbijetesën dhe përparimin personal.

Pikërisht për këtë arsye, njerëzit kanë filluar të grupohen në lloje të ndryshme të bashkësive, me çka është krijuar shoqëria. Funksionimi në bashkësi njerëzve ju mundësoi që gradualisht ta risin ndikimin e tyre ndaj natyrës dhe ti përsosin mjetet e punës. Në këtë mënyrë shoqëria ndryshon dhe zhvillohet vazhdimisht. Për shembull, me zbulimin e rrotës është mundësuar lëvizja më e lirë e njerëzve, e me këtë edhe komunikim më i madh mes tyre, si dhe transport më i lehtë i ushqimit dhe i materialeve.

Që shoqëria të mund të mbijetojë, njerëzit kanë komunikuar dhe kanë mbajtur lidhje pozitive. Në bazë të vlerave të përbashkëta ata kanë krijuar dhe vendosur rregulla të caktuara të cilat duhej të respektoheshin nga të gjithë. Sipas kësaj, **shoqëria** paraqet grup të organizuar të njerëzve të cilët kanë lidhje të ndërsjella dhe jetojnë së bashku në bazë të rregullave të përbashkëta.

Me kalimin e kohës është paraqitur nevoja e ekzistimit të **institucioneve**, gjegjësisht organeve të vendosura formale që funksionojnë në bazë të rregullave të vendosura qartë, përmes të cilave njerëzit mund t'i realizojnë nevojat e tyre në mënyrë të organizuar. Krahas institucioneve, në një nivel të caktuar të zhvillimit të shoqërisë është krijuar edhe shteti, si rezultat i bashkimit të njerëzve.

**Shteti** vendosë pushtetin, rendin, organizimin dhe mbrojtjen e një territori dhe banorëve të saj. Shteti siguron respektim të rregullave të vendosura, e me këtë edhe siguri dhe paqe në shoqëri. Për dallim nga shoqëria, shteti posedon mekanizma, gjegjësisht institucione, përmes të cilave mund të sigurohet që njerëzit t'i respektojnë rregullat e vendosura të cilat janë në interes të së mirës së përgjithshme të të gjithë qytetarëve. Prej këtij rezultati edhe përkufizimi për shtetin si shoqëri e organizuar, përmbledhje e institucioneve që krijojnë dhe zbatojnë rregulla në një territor të caktuar, të dedikuara për popullatën atij territori.

Secili shtet ka disa shenja: territor, popullatë dhe pushtet publik. Territori është i domosdoshëm për funksionimin e shtetit. Ai është në fakt hapësira në të cilën shteti e ushtron pushtetin e tij, i përcaktuar me kufij të përkufizuar qartë, përmes të cilave shteti ndahet nga shtetet fqinje. Popullatën e përbëjnë njerëzit të cilët jetojnë në një territor të caktuar shtetëror. Popullata e një shteti i përfshinë shtetasit e atij shteti, si dhe të huajt që qëndrojnë në territorin e atij shteti. Kur flitet për ushtrimin e pushtetit publik, kjo do të thotë se shtetet kanë kompetencë të përdorin mekanizma për mbrojtjen e rendit juridik në përputhje me ligjet. Për shembull, nëse ndonjë qytetar e shkatërron hapësirën publike, policia për një shkellje të tillë ka të drejtë të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore.

Shtetet mund të grupohen sipas një numri të madh të kriterëve të ndryshme, por megjithatë njëra prej ndarjeve më të rëndësishme është ndarja në shtete demokratike dhe jodemokratike. Në shtetet demokratike pushteti duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet. Kjo do të thotë se organet shtetërore dhe institucionet duhet të qeverisin vetëm sipas së drejtës dhe të gjithë njerëzit të jenë të barabartë para ligjit. Më tutje, me qëllim që të parandalohet përqendrimi tepër i madh i fuqisë në një institucion, pushteti është i ndarë në më shumë institucione të pavarura prej njëra-tjetrës (ndarja e pushtetit).

Gjithashtu është me rëndësi të përmendet se në shtetet demokratike pushteti mbështetet në pajtueshmërinë e shumicës së qytetarëve, gjegjësisht ai është në duart e përfaqësuesve të zgjedhur përmes zgjedhjeve korrekte, të lira, shumëpartiake dhe demokratike. Llojllojshmëria politike, por edhe ajo shoqërore dhe ekonomike kontribuojnë në përmirësimin e së mirës së përgjithshme të të gjithë

qytetarëve. Në këtë mënyrë nxitet bashkëpunimi mes të gjithë qytetarëve dhe grupeve në shoqëri, shkëmbehen ide dhe qëndrime të ndryshme dhe qytetarëve u mundësohet të marrin vendime të informuara për çështje që janë në interes të tyre.

Në të gjitha shtetet demokratike, kushtetuta dhe institucionet garantojnë mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut edhe të gjithë qytetarëve, pa përjashtim. Kjo do të thotë se krahas faktit që ekzistojnë ligje përkatëse, në shtet ka edhe institucione efektive përmes të cilave njerëzit mund t'i realizojnë dhe t'i mbrojnë të drejtat e tyre.

Në shtete jodemokratike elementet e sipërpërmendura nuk respektohen ose janë dukshëm të zvogëluara. Në to nuk ekziston angazhim për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Shtetet jodemokratike nuk u sigurojnë qytetarëve të tyre barazi, liri, drejtësi dhe pjesëmarrje dhe zakonisht një person ose një grup i vogël i njerëzve sundon me të tjerët në mënyrë arbitrare. Është vështirë të matet se sa është demokratike një shoqëri, veçanërisht për shkak se demokracia në shtet nuk është e siguruar një herë e përgjithmonë, por avancohet vazhdimisht.





## Vallë, e keni ditur se...


1

Kur në një shtet ka ambasadë të një shteti tjetër, territori ku gjendet ambasada konsiderohet se **është territor i shtetit që e përfaqëson**.

2

Kina dhe India janë shtete **me numër më të madh të popullatës** dhe së bashku përbëjnë më shumë se një të tretën e popullatës së përgjithshme në botë.





# Aktivitet në orë


## Aktiviteti 1:

**PUNË NË ÇIFTE:** Krahasoni kuptimet shtet dhe shoqëri. Paraqitini ngjashmëritë dhe dallimet mes këtyre dy kuptimeve. Më pas, prezantoni rezultatet në nivel të paraleles.

## Aktiviteti 2:

**PUNË INDIVIDUALE:** Paramendoni se në çfarë shteti do të donit të jetoni dhe shkruani një ese në të cilin do t'i sqaroni karakteristikat e shtetit ideal, sipas qëndrimeve tuaja. Diskutoni për idetë e ndryshme që do të paraqiten në esetë e punuara.





## Aktivitet në bashkësi

### *Punëtori për të rinjtë për pjesëmarrje qytetare*

---

- Organizoni punëtori për ju dhe nxënësit tjerë në shkollë në formë të ligjëratës ose diskutimit të hapur me persona që kanë njohuri dhe përvojë në temën: „Roli i institucioneve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut“. Hapi i parë është që të caktoni datën, kohën dhe vendin ku do të mbahet punëtorja. Më pas duhet të ftoni persona që kanë njohuri nga kjo temë – për shembull: përfaqësues të institucioneve, përfaqësues të Këshillit Lokal Rinor në komunë, etj. Informoni oratorët dhe kërkoni të mbajnë një ligjëratë të shkurtër ose një fjalim të shkurtër. Pas fjalimeve duhet të parashikohet pjesa për pyetje dhe përgjigje, gjegjësisht diskutim me nxënësit e pranishëm dhe mysafirët oratorë.



# PUSHTETI në funksion të qytetarëve

Shtetin e kanë krijuar qytetarët, ndërsa popullata është njëra prej karakteristikave themelore të secilit shtet. Pikërisht për këtë arsye realizimi i pushtetit publik dhe politikës së shtetit duhet të jenë në interes të qytetarëve.

Nocioni politikë në kuptimin më të gjerë mund të kuptohet si proces i marrjes së vendimeve dhe i rregullave që kanë të bëjnë me anëtarët e një grupi dhe janë në drejtim të arritjes së qëllimeve të caktuara. Në kuptimin më të ngushtë të fjalës, **politika** përkufizohet si aktivitet i orientuar drejt të menduarit, organizimit, udhëheqjes dhe rregullimit të jetës së përbashkët të njerëzve në një bashkësi të caktuar, në përputhje me nevojat, interesat dhe vlerat e tyre.

Politika shpesh ndërlidhet me kuptimet fuqi dhe pushtet. **Fuqia** paraqet aftësinë e një individi ose një grupi të njerëzve për të ndikuar në sjelljen e individëve tjerë, ndërsa, **pushteti** është e drejta për ta bërë atë. Pushteti në fakt është **fuqi institucionale dhe legjitime**. Kjo do të thotë se shteti duhet ta zbatojë fuqinë në përputhje me rregullat e përcaktuara (sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve tjera), e nga ana tjetër rregullat të konsiderohen të arsyeshme edhe nga qytetarët edhe nga pushteti.

Në rregullimin e marrëdhënieve në shoqëri në shtetet demokratike, bartësit e pushtetit nisen nga qëllimet dhe interesat e përbashkëta, me ç'rast njëri prej qëllimeve themelore është që të ofrojë siguri për shtetin dhe qytetarët e saj. Gjithashtu shteti ka funksion të sigurojë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave e të gjithë qytetarëve dhe të zbatojë drejtësinë. Shteti ka edhe një numër të madh të funksioneve tjera, në fusha të ndryshme, si për shembull: ekonomi, kulturë, arsim, shëndetësi, etj. Është me rëndësi se gjatë ushtrimit të posteve, bartësit e pushtetit duhet t'i përfaqësojnë interesat dhe nevojat e qytetarëve, meqë pikërisht për këtë janë zgjedhur prej tyre në zgjedhje të lira, të fshehta dhe të drejtpërdrejta. Megjithatë, pjesëmarrja e qytetarëve nuk përfundon me zgjedhjen e përfaqësuesve në pushtet. Krahas zgjedhjeve, ekzistojnë një numër i madh i mekanizmave përmes të cilëve mundësohet ndikimi i qytetarëve mbi pushtetin, gjegjësisht kontrolli ndaj pushtetit.

Para së gjithash qytetarët kanë në dispozicion forma të ndryshme të shprehjes së mendimit të tyre. Ata mund të kontaktojnë me bartësit e pushtetit (përmes letrës, postës elektronike dhe ngjashëm) dhe t'i shprehin qëndrimet e tyre për një temë të caktuar, t'i shkëmbejnë idetë e tyre për zgjidhjen e ndonjë çështjeje, t'i informojnë për nevojat e tyre ose të parashtrajnë ndonjë kërkesë, etj. Për shembull: secili qytetar ka të drejtë të dorëzojë te kryetari i komunës propozime dhe parashtrësia për punën e komunës. Kështu, nëse të rinjtë në një komunë të caktuar duan të kenë terren sportiv mund t'i drejtohen komunës. Gjithashtu, qytetarët mund të marrin pjesë në debate, tribuna publike dhe ngjarje tjera ku mund të diskutojnë për tema të ndryshme me interes publik.

Qytetarët mund të ndikojnë mbi pushtetin edhe përmes asociimit me qytetarë tjerë që kanë interesa të njëjtë ose të ngjashëm për arritjen e ndonjë qëllimi konkret. Qytetarët mund të bashkohen në parti politike dhe në forma jopartiake të asociimit, si për shembull në organizata qytetare, shoqata qytetare, sindikata, grupe ekologjike, etj. Në këtë mënyrë ata mund të ndikojnë mbi pushtetin përmes realizimit të hulumtimeve për disa çështje të caktuara, kërkim të informacioneve për punën e pushtetit, etj. Gjithashtu, qytetarët mund të protestojnë, të bëjnë grevë dhe të ushtrojnë forma tjera të shprehjes së pakënaqësisë. Në fakt, përmes këtyre mekanizmave ata mund të ndikojnë mbi pushtetin që të marrë vendime që janë në interes të qytetarëve.

Disa prej formave tjera përmes të cilave qytetarët mund të ndikojnë mbi pushtetin janë iniciativa qytetare dhe referendumi. Përmes iniciativës qytetare qytetarët propozojnë marrjen e vendimeve ose ligjeve të caktuara që janë në interes të bashkësisë. Përmes referendumit qytetarët shprehen për një çështje të caktuar me rëndësi të veçantë për bashkësinë.

Të gjitha këto mekanizma që janë parashikuar në shtetet demokratike u ofrojnë qytetarëve mundësinë që të jenë kreatorë aktiv të proceseve demokratike, e jo të mbetën vetëm si vëzhgues pasiv të tyre.



## Vallë, e keni ditur se...

1

Kuptimi politikë përkufizohet edhe si „art i sundimit“.

2

Seancat e këshillave të komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë publike dhe secili qytetar i interesuar mund të jetë i pranishëm pa paralajmërim.






## *Aktivitet në orë*

**PUNË NË GRUPE:** Duke shfrytëzuar faqen e internetit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve hulumtoni veprimet demokratike dhe procedurat gjatë zgjedhjeve. Më pas, simuloni zgjedhje për kryetar të klasës në bazë të parimeve demokratike.





## Aktivitete në bashkësi

### Kërkesë drejtuar shkollës për nevojat e nxënësve

---

- ▶ Diskutoni për atë se cila është nevoja më e rëndësishme për ju brenda shkollës. Sipas asaj që do ta konstatoni, bëni një listë të nevojave që do të kishit dashur t'ia parashtroni drejtorit të shkollës. Për shembull: drita jofunkionale në ndonjërin prej klasave, mungesë e detergjenteve në ndonjërin prej tualeteve, mbeturina në një pjesë të oborrit të shkollës dhe ngjashëm. Më pas në formë të shkruar sqaroni arsyet për të cilat i drejtoheni drejtorit të shkollës. Pasi ta shkruani kërkesën, dorëzoni drejtorit të shkollës.

### Vizitë në komunë

---

- ▶ Në koordinim me arsimtarin përcaktoni një vizitë te kryetari i komunës. Para vizitës bisedoni në klasë dhe bëni një listë me pyetje që dëshironi ti parashtroni kryetarit të komunës.

Gjatë vizitës do të mund të njoftoheni me punën e komunës dhe kryetarit të saj. Më pas përpiloni një prezantim të shkurtër për përshtypjet nga vizita.

# SI ËSHTË I ORGANIZUAR PUSHTETI *në shtetin tonë*

## *Çfarë është ndarja e pushtetit?*

Në leksionet e mëparshme mësuam se ndarja e pushtetit është njëra prej karakteristikave themelore të sistemeve demokratike. Parimi i ndarjes së pushtetit nënkupton se pushteti në një shtet është i ndarë në disa degë, me ç'rast secila prej tyre ka autorizime të posaçme dhe të pavarura në fushën e saj të sundimit. Qëllimi i ndarjes së pushtetit është që të parandalohet përqendrimi i fuqisë në një qendër, institucion ose individ, për të siguruar qeverisje të mirë.

Me ndarjen e pushtetit vendoset edhe sistem i kontrollit dhe baraspeshës mes llojeve të ndryshme të pushtetit – pushtetet mund të kontrollohen dhe kufizohen mes vete. Për shembull, pushteti ligjdhënës (Kuvendi) i miraton ligjet, por pushteti gjyqësor (Gjykata Kushtetuese) ka të drejtë të anulojë ose pezullojë një ligj nëse vërteton se nuk është në përputhje me Kushtetutën.

## *Si është i ndarë pushteti në shtetin tonë?*

Ndarja e pushtetit është në fakt themeli i çdo demokracie, ndaj edhe në shtetin tonë nuk ka pushtet absolut. Për një qeverisje të mirë, pushteti është i ndarë në ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Secili prej tre pushteteve ka qëllime dhe detyra specifike. Kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre janë të përkufizuara në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me fjalë tjera, pushteti ligjdhënës i miraton ligjet, ai ekzekutiv i zbaton ato, ndërsa pushteti gjyqësor e garanton respektimin e përpiktë të tyre.

Tre llojet e pushtetit janë të pavarura njëra prej-tjetrës dhe asnjëri pushtet nuk ka të drejtë të ndërhyjë në kompetencat e pushteteve tjera. Megjithatë, ata duhet të bashkëpunojnë mes vete me qëllim që të sigurohet funksionim i mirë i shtetit.

## *Pushteti ligjdhënës*

Bartës i pushtetit ligjdhënës në shtetin tonë është **Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut**. Kuvendi është organ ligjdhënës meqë është institucioni i vetëm që ka kompetencë t'i miratojë, ndryshojë dhe plotësojë ligjet. Kuvendi është edhe organ përfaqësues meqë i përfaqëson qytetarët të cilët çdo katër vite në zgjedhje parlamentare e zgjedhin përbërjen e Kuvendit. Përfaqësuesit e zgjedhur në Kuvend quhen deputetë.

Me miratimin e ligjeve Kuvendi në fakt parashikon se si do të rregullohet një fushë e caktuar nga jeta shoqërore. Kuvendi ka kompetencë të miratojë dhe ndryshojë edhe Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Gjithashtu, Kuvendi e zgjedhë pushtetin ekzekutiv (Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut), ndaj për këtë arsye Qeveria përgjigjet para deputetëve për punën e saj. Kjo është njëra prej mënyrave për kontroll të ndërsjellë të punës së pushteteve të ndryshme.

## *Pushteti ekzekutiv*

Bartësit e pushtetit ekzekutiv në shtetin tonë janë **Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut**.

Qeverinë e përbëjnë kryetari i Qeverisë (kryeministri) dhe ministrat, si anëtarë të saj të cilët i drejtojnë ministrinë. Përgjegjësia kryesore e Qeverisë është që t'i zbatojë ligjet dhe rregullat tjera që i miraton Kuvendi. Meqë ndarja e pushtetit nënkupton edhe bashkëpunim mes autoriteteve, ekziston mundësia që Qeveria edhe t'i propozojë ligje Kuvendit. Qeveria e organizon punën e ministrive dhe e ndjekë punën e tyre.

**Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut** është gjithashtu pjesë e pushtetit ekzekutiv dhe është shef i shtetit. Zgjidhet në zgjedhje presidenciale, me votim të fshehtë, me mandat në kohëzgjatje prej pesë vitesh. Kompetencat e tij janë kryesisht në fushën e mbrojtjes dhe politikës ndërkombëtare. Ai është komandant suprem i forcave të armatosura, kryeson Këshillin e Sigurimit dhe e përfaqëson shtetin në vend dhe jashtë.

## **Pushteti gjyqësor**

Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë **gjykatat**, si organe që janë të pavarura nga pushtetet tjera. Funkzioni kryesor i gjykatave është që të garantojnë respektim të vazhdueshëm të ligjeve, gjegjësisht të gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve. Me qëllim që të sigurohet zbatim i drejtë i ligjeve në shtetin tonë ekzistojnë disa nivele të gjykatave. Për shembull, nëse ndonjë qytetar nuk është i kënaqur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore (të shkallës së parë), ka të drejtë të ankohen në Gjykatën e Apelit (të shkallës së dytë).

## **Njësi të vetëqeverisjes lokale (komuna)**

Bartësit e pushtetit ligdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor në shtetin tonë janë **organe qendrore**. Kjo do të thotë se vetëm ato e kanë pushtetin në tërë territorin e shtetit. Mirëpo, për realizimin më të mirë dhe më efikas të pushtetit shtetëror, shteti është i ndarë në më shumë **njësi të vetëqeverisjes lokale (komuna)**. Qytetarët në zgjedhje lokale zgjedhin kryetarët e Komunave dhe Këshillat e Komunave, të cilët janë kompetentë për funksionimin e Komunave. Pjesë e kompetencave të komunave janë: mbrojtja e mjedisit jetësor, higjiena komunale, planifikimi urbanistik, zhvillimi ekonomik, kultura, arsimit, sporti, etj.



## Vallë, e keni ditur se...


1

Si kusht i posaçëm për zgjedhjet presidenciale në shtetin tonë është që kandidati të jetë mbi moshën 40 vjeçe.

2


Ndërtesa e Parlamentit gjerman ka kube prej qelqi nën të cilën ka shteg për lëvizjen e vizitorëve, simbolika e të cilës është që t'i përkujtojë deputetët se duhet t'i përfaqësojnë interesat e qytetarëve.






## *Aktivitet në orë*

**PUNË E PAVARUR:** Bëje një skemë/pasqyrë të ndarjes së pushtetit në shtetin tonë. Krahasoje me nxënësin/nxënësen pranë teje. Bisedoni se çfarë është paraqitur mirë në skemën/pasqyrën tënde, e çfarë në pasqyrën e nxënësit tjetër?





## *Aktivitet në bashkësi*

- ▶ **Me ndihmën e arsimtarit organizoni vizitë në një institucion sipas zgjedhjes tuaj:** Kuvend, Qeveri, President i shtetit, Gjykatë, Komunë. Përgatitni pyetje që do t'i parashtroni gjatë vizitës, e më pas diskutoni për përshtypjet nga vizita.



Tema

6

# QYTETARI DHE BOTA

Qëllimi  
i kësaj  
teme

është të  
sqarojë rolin e  
organizatave  
ndërkombëtare,  
funksionimin e  
tyre dhe përfitimet  
nga pjesëmarrja e  
shtetit tonë në to.



# Organizatave NDËRKOMBËTARE

Shtetet kanë më shumë funksione – ruajtjen e paqes dhe sigurisë, realizimin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë, sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, etj. Për t'i realizuar funksionet e tyre më mirë dhe më lehtë, ato kanë filluar të bashkëpunojnë mes vete.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është në fakt rezultat i nevojës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në të gjitha shtetet e botës, domosdoshmërisë për shkëmbim të resurseve, shpikjeve shkencore dhe teknologjike, bashkëpunimit ekonomik dhe bashkëpunimit tjetër mes shteteve. Kështu, në shoqërinë bashkëkohore ekziston rritje e tregtisë ndërkombëtare përmes qarkullimit më të madh të mallrave dhe parave; qarkullimit më të madh të të dhënave përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore, si telefoni, interneti, etj.; shkëmbim më i madh kulturor (për shembull, eksport të filmave, muzikës), si dhe qarkullim më i madh i njerëzve, gjegjësisht turizmi ndërkombëtar. Sot bota është më e lidhur se kurdoherë në historinë e njerëzimit. Për t'u përshkruar të gjitha këto ndryshime përdoret kuptimi **globalizim**.

Përfitimet që i sjellë bashkëpunimi ndërkombëtar janë të shumta. Para së gjithash, shtetet mund t'i arrijnë qëllimet e veta të cilat ndryshe nuk do të mund t'i arrinin vetë. Gjithashtu, përmes zhvillimit të marrëdhënieve pozitive ndërkombëtare, shtetet mund të gjejnë zgjidhje të ndryshme për problemet e tyre, si dhe t'i zgjidhin problemet që janë të përbashkëta për më shumë shtete.

Me kalimin e kohës, për të siguruar mbrojtje nga pengesa e bashkëpunimit mes shteteve, rregullat mbi të cilat bazohet bashkëpunimi filluan të bëhen më të fuqishme dhe më qartë të përkufizuara. Që rregullat e vendosura të mund të funksionojnë në bashkësinë ndërkombëtare, është paraqitur edhe nevoja për krijimin e **organizatave ndërkombëtare**.

Për nocionin organizatë ndërkombëtare ekzistojnë më shumë përkufizime, në të cilat më së shpeshti organizatat ndërkombëtare përkufizohen si asociacione të shteteve (por edhe subjekte tjera juridike) që krijohen në bazë të rregullave dhe parimeve të caktuara për realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Periodha e krijimit të organizatave bashkëkohore ndërkombëtare fillon me krijimin e Shoqatës së Popujve në vitin 1919. Krijimi i kësaj organizate është i lidhur drejtpërdrejt me përfundimin e Luftës së Parë Botërore. Pikërisht për shkak të pasojave shkatërruese nga lufta, njerëzimi ka ndërmarrë një angazhim të këtillë në planin botëror që shtetet në të ardhmen të mund të përballen në mënyrë të organizuar me shkeljet potenciale të paqes dhe sigurisë. Periudhën e shekullit XX disa e quajnë „shekulli i organizatave ndërkombëtare”, meqë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, e deri sot janë krijuar një numër i madh i organizatave ndërkombëtare.

Ndonëse ekzistojnë më shumë mënyra të klasifikimit të organizatave ndërkombëtare, ato mund të ndahen në dy grupe më të mëdha – universale dhe rajonale. Universalet kanë tendencë t’i përfshijnë të gjitha shtetet ekzistuese, derisa ato rajonalet i përfshijnë shtetet e një rajoni.

**Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)** është njëra prej organizatave të para universale. E themeluar pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945, kjo organizatë është pasardhëse e Shoqatës së Popujve. Qëllimi themelor i OKB-së është **ruajtja e paqes në botë**.

Në kuadër të OKB-së funksionojnë trupa të ndryshëm në mesin e të cilëve edhe **Fondi Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara (UNICEF)**. Detyra themelore e UNICEF-it është që të kujdeset për të drejtat e fëmijës. Kjo mund të realizohet përmes aktiviteteve për sigurimin e kushteve themelore për jetë të fëmijëve, mbrojtje të shëndetit të fëmijëve, arsim cilësor, etj.

**Këshilli i Evropës (KE)** është organizatë ndërkombëtare rajonale e themeluar në vitin 1949. Kjo organizatë i bashkon shtetet e Evropës rreth vlerave themelore demokratike: liri, të drejta të njeriut dhe sundim i ligjit. Këshilli i Evropës është më i njohur në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

**Bashkimi Evropian (BE)**, siç njihet sot, është themeluar në vitin 1993, ndonëse krijimi i saj ka filluar që në vitin 1951. Kjo organizatë është në fakt bashkësi e shteteve që gjenden në Evropë. Ndonëse BE-ja si organizatë ndërkombëtare ka institucionet dhe kompetencat e saj të posaçme, megjithatë është e domosdoshme të bashkëpunojë me shtetet anëtare të saj. Qëllimet

kryesore të BE-së janë: avancimi i paqes, vendosja e zonës së përbashkët të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, vendosja e tregut të përbashkët të brendshëm, avancimi i mirëqenies ekonomike dhe sociale të popujve të saj dhe forcimi i solidaritetit mes anëtarëve të saj.

**Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Evropë (OSBE)** është krijuar në vitin 1975. Roli i saj është orientuar drejt çështjeve të mbrojtjes, sigurisë dhe stabilizimit të rajonit të Evropës, e më vonë edhe më gjerë, me ndihmën e mjeteve demokratike dhe qeverisjes demokratike.

**Aleanca Veri-Atlantike (NATO)** është organizatë e themeluar në vitin 1949. Në NATO janë anëtare shtete nga Evropa dhe Amerika e Veriut me qëllim që të sigurohet bashkëpunim politik dhe i sigurisë mes shteteve anëtare.

**Federata e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhëna e Kuqe** është njëra prej organizatave më të rëndësishme humanitare në botë. Ajo i promovon parimet dhe vlerat humanitare, siguron ndihmë në situata të jashtëzakonshme me përmasa më të mëdha, ofron mbështetje për mbrojtjen shëndetësore, etj.

Lista e organizatave ndërkombëtare është shumë e gjatë, akoma më e gjatë është lista e aktiviteteve dhe misionëve të tyre që kanë kontribuar në mirëqenien e njerëzimit. Rëndësia e ekzistimit të organizatave ndërkombëtare në raport me përfitimet për njerëzimin është e pallogaritshme.





## Vallë e keni ditur se...


1

Në nenin e parë të Kartës së OKB-së qëndron: „Ne popujt e Kombeve të Bashkuara jemi të vendosur t’i shpëtojmë brezat e ardhshëm nga tmerret e luftës që dy herë gjatë jetëve tona i shkaktuan njerëzimit vuajtje të papara”.

2

Përmes Fondit Ndërkombëtar për Fëmijët të Kombeve të Bashkuara (UNICEF) në vitin 2016 janë furnizuar **2,5 miliardë doza të vaksinave të dedikuara për fëmijë që nuk kanë qasje deri te ato**. Me vaksinimin e fëmijëve nga mjediset e rrezikuara diku rreth dy deri tre milionë jetë shpëtohen në vit prej sëmundjeve si fruthi, diarreja dhe pneumonia. Për shembull, prej vitit 2000 e këndej kundër sëmundjes polio janë vaksinuar 2,5 miliardë fëmijë me çka paraqitja e kësaj sëmundjeje është zvogëluar për 99 për qind.





## Aktivitet në orë




### HULUMTIM NË INTERNET


---

1. Organizata ndërkombëtare ndërqeveritare.
2. Organizata ndër-joqeveritare ndërkombëtare.
3. Organizata ndërkombëtare globale, universale.
4. Organizata ndërkombëtare rajonale.

Përmes hulumtimit (në internet, enciklopedi, libra dhe tekste shkollore, etj.) përpilohet prezantim për një organizatë të caktuar ndërkombëtare.

- ➔ Gr.1. Ekspertë për punën e OKB-së.
- ➔ Gr.2. Ekspertë për punën e NATO-s.
- ➔ Gr.3. Ekspertë për punën e KE-së (Këshilli i Evropës).
- ➔ Gr.4. Ekspertë për punën e UNICEF-it.







## Aktivitet në bashkësi

- ▶ Ndahuni në grupe dhe lokalizoni së paku 5 objekte në qytetin tuaj, që janë ndërtuar me mbështetje financiare të ndonjë organizate ndërkombëtare (për shembull: USAID, Bashkimi Evropian, ambasada, etj.). Për secilin objekt përmendeni emrin e organizatës ndërkombëtare, periudhën e ndërtimit, shumën e mjeteve financiare (nëse është në dispozicion) dhe emrin e projektit.

Përmes këtij aktiviteti do të mësoni se sa ndihmojnë organizatat ndërkombëtare në zhvillimin infrastrukturor të qytetit tuaj.






## Aktivitet në shkollë

- ▶ Bëni një intervistë me arsimtarë/bashkëpunëtorët profesional lidhur me përfitimet e shkollës suaj nga përfshirja e shkollës në aktivitete të organizatave ndërkombëtare (projekte dhe programe – për shembull ERASMUS+). Pyetjet mund të përfshijnë: 1) si kanë ndihmuar programet ndërkombëtare në zhvillimin e shkollës, 2) a ka ndihmuar ndonjë organizatë në përmirësimin e kushteve infrastrukturore në shkollë, 3) a kanë pasur mundësi arsimtarët të ndjekin trajnim plotësues, etj.

Qëllimi i aktivitetit është që të merrni më shumë informacione për përfitimet që i ka shkolla juaj nga mbështetja e organizatave ndërkombëtare.



# Shteti ynë

## DHE ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Paraprakisht folëm për rëndësinë e bashkëpunimit mes shteteve në botë. Kjo vlen edhe për shtetin tonë. Përmes bashkëpunimit me shtete tjera dhe organizata ndërkombëtare, shteti ynë zhvillohet më mirë, komunikon dhe tregton më mirë, bëhet më i sigurt dhe kujdeset më mirë për qytetarët e tij. Ekzistojnë shumë mënyra në të cilat bashkëpunojnë organizatat ndërkombëtare dhe u japin mbështetje shteteve anëtare.

Organizatat ndërkombëtare miratojnë akte të ndryshme (për shembull: kontrata, vendime, rregullore) të cilat më pas shtetet i marrin dhe i inkorporojnë në legjislacionin vendor për të rregulluar më mirë disa çështje të caktuara nga jeta shoqërore. Për shembull, Republika e Maqedonisë së Veriut në procesin e anëtarësimit në **Bashkimin Evropian (BE)** e përshtatë legjislacionin vendor me legjislacionin BE-së.

Organizatat ndërkombëtare gjithashtu mund të kenë rol këshillëdhënës për shtetet anëtare – të japin mendime dhe rekomandime për çështje të caktuara ose të formojnë trupa të ndryshëm këshillëdhënës për qëllime të caktuara. Shteti ynë me anëtarësimin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) u bë anëtare e të gjitha agjencive, programeve dhe fondeve të specializuara të OKB-së. Për shembull, si pjesë e OKB-së, UNICEF-i në shtetin tonë përmes dhënies së rekomandimeve, realizimit të hulumtimeve dhe sigurimit të mbështetjes, kontribuon në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, përmirësimin e shëndetit dhe në përgjithësi jetës së fëmijëve, si dhe në përmirësimin e arsimit.

Në disa raste, organizatat ndërkombëtare i promovojnë dhe i mbrojnë të drejtat e njeriut. Për shembull, me anëtarësimin e shtetit tonë në Këshillin e Evropës, qytetarëve u është mundësuar të parashetrojnë padi për shkak të shkeljes së ndonjë të drejte që rezulton nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si organ i Këshillit të Evropës.

Gjithashtu, organizatat ndërkombëtare mund të sigurojnë edhe qasje të shteteve deri tek fondet për zhvillim. Përmes posedimit të fondeve të këtilla, shtetet mund të përshpejtojnë dhe ta përmirësojnë cilësinë e zhvillimit të tyre. Për shembull, Bashkimi Evropian siguron fonde për zhvillimin e shteteve anëtare, por edhe të vendeve candidate, siç është shteti ynë. Me mjetet nga këto fonde, qytetarët, ndërmarrjet dhe institucionet mund të investojnë në dituri të reja, në shkathtësi, në teknologji bashkëkohore, etj. Gjithashtu, përmes fondeve të UNESCO-s (organizatë e OKB-së), shteti ynë punon në ruajtjen e trashëgimive kulturore dhe natyrore që gjenden në territorin tonë.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mund të jetë edhe në drejtim të forcimit të sigurisë së shtetit. Shembull i këtillë është Aleanca Veri-Atlantike (NATO) në të cilën Maqedonia e Veriut është vend kandidat për anëtarësimin e saj me statut të plotëfuqishëm.

Gjithashtu ekzistojnë edhe organizata ndërkombëtare të fokusuara në ndihmë dhe bashkëpunim humanitar, si për shembull **Kryqi i Kuq** në shtetin tonë, i cili në vitin 1995 u bë anëtar i plotëfuqishëm i Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Në përputhje me dispozitat dhe mbështetjen e Federatës, Kryqi i Kuq vazhdimisht punon dhe kontribuon në parandalimin dhe zbutjen e vuajtjes së njeriut, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit. Ai, gjithashtu, i nxitë aktivitetet vullnetare me qëllim të dhënies së ndihmës, veçanërisht në raste të fatkeqësive të ndryshme.

Ndonëse organizatat ndërkombëtare janë formuar për shkak të qëllimeve të ndryshme, e përbashkët për të gjithë ato është fakti se të gjitha punojnë në drejtim të rritjes së bashkëpunimit me shtetet, mbështetjen e zhvillimit të shteteve, si dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve në përgjithësi. Me anëtarësimin e shtetit tonë në organizata ndërkombëtare, qytetarët tanë bëhen edhe qytetarë të botës.



## Vallë, e keni ditur se...

1

Në vitin 1979 është vendosur nga UNESCO se **Liqeni i Ohrit** do të hyjë në kategorinë „**Trashëgimi botërore e UNESCO-s**”, si zonë e mbrojtur legalisht, liqeni më i vjetër në botë dhe njëri prej më të thellëve në botë, i cili është vendbanimi i më shumë se 200 llojeve endemike.





## Aktivitetet në orë



### HULUMTIM:

---

- ▶ Hulumtoni se cilat përfaqësi të organizatave ndërkombëtare gjenden në shtetin tonë. Më pas ndahuni në grupe dhe zgjidhni një të një prej këtyre organizatave dhe hulumtoni se cilat aktivitete i kanë realizuar vitin e kaluar. Prezantoni të dhënat para nxënësve tjerë.
- ▶ Hulumtoni objekte ose mjedise natyrore që gjenden në shtetin tonë dhe janë të mbrojtura nga UNESCO. Më pas ndahuni në grupe dhe zgjidhni një lokalitet ose mjedis natyror të mbrojtur nga UNESCO dhe hulumtoni se cilat aktivitete janë ndërmarrë për mbrojtjen e tyre. Prezantoni të dhënat para nxënësve tjerë.

### DISKUTIM:


---

Diskutoni për ndikimin e globalizimit në zhvillimin e shteteve dhe për rolin e organizatave ndërkombëtare në këtë proces.

Bisedoni për atë se si ndryshimet bashkëkohore ndikojnë në jetën e përditshme të njerëzve, veçanërisht në krahasim me të kaluarën. Mund të diskutoni për shumë aspekte, si për shembull tregtia ndërkombëtare, shkëmbimi kulturor, përparimi teknologjik dhe ngjashëm. Nëse paraqiten qëndrime të ndryshme, debatoni për to.

Konstatimet shënoni në formë të argumenteve.

Përmendni tre argumente për përparësitë dhe tre argumente për sfidat që kanë të bëjnë me globalizimin.



# Literatura e shfrytëzuar

---

- Армстронг, К. (2008). *Битката за Бога*. Евро Балкан Пресс.
- Атанасов, П. (2003). *Мултикултурализмот како теорија, политика и пракса*. Евро Балкан Пресс.
- Базерковска, Ј., Биерман, Е., Болдт, Г., Френг Дејл, Е., Герлах, П., Гогл, И., Шеги, М., Селун, Б., Торал Мартинез, Г., Токслер, Д. И Вулф, Антониа. (2014). *Декларација и прирачник за средношколци*. Младински образовен форум.
- Бајалциев, Д. (2007). *Вовед во правото*. Академски печат.
- Бенедек, В. ур. (2006). *Разбирање на човековите права: Прирачник за едукација од областа на човековите права*. Македонски Информативен Центар во соработка со Директоратот за јавна дипломатија при Министерството за надворешни работи на Република Македонија. (достапно на: [http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user\\_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/macedonian/RAZBIRANJE\\_NA\\_COVEKOVITE\\_PRAVA\\_-\\_Priracnik\\_za\\_edukacija\\_od\\_oblasta\\_na\\_covekovite\\_prava.pdf](http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/macedonian/RAZBIRANJE_NA_COVEKOVITE_PRAVA_-_Priracnik_za_edukacija_od_oblasta_na_covekovite_prava.pdf))
- Георгиевска, Б., Петровска, М., Ристов, Д., Соколова, В., Андонова, М., Љубиноски, Г., Ристеми, А., Реџеми, Ф., Мерковска, М. и Јовческа, С. (2015). *Младите одлучуваат, развој на младински локални совети*. Младински образовен форум и Центар за меѓукултурен дијалог.
- Георгиевска, Е. и Новеска, Љ. (2016). *Анализа на случаи од стратешко застапување*. Адд-Верта ЛТД дооел.
- Голоб, Р. и Краф, П. (2008). *Живеење во демократија*. Совет на Европа. (достапно на: <http://www.living-democracy.com/mk>)
- Голоб, Р. и Краф, П. (2010). *Растење во демократија*. Совет на Европа.
- Грнчаревки, В. и Бачовска, Ј. (2013). *Основи на правото*. Министерство за образование и наука на Република Македонија.
- Додовски, И. ур. (2005). *Мултикултурализмот во Македонија: модел во настанување*. Фондација Институт Отворено Општество.
- Европски суд за човекови права, Совет на Европа. (1950). *Европска конвенција за заштита на човековите права*. Европски суд за човекови права, Совет на Европа. (достапно на: [http://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_MKD.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf))
- Избутс, П. (2005). *Мојсеј, Исус, Мухамед—Археолошка историја на трите вери*. АЕА.
- Кениг, Н. и Дедова, Р. (2013). *Прирачник за наставници во основните училишта за теми од областа на сексуалното и репродуктивното здравје и права*. ХЕРА-Асоцијација за здравствена едукација и истражување.
- Климовски, С., Каракамишева Т. и Дескоска Р. (2009). *Политички систем*. Академски печат.

- Комисија за односи со верските заедници. (2010). *Верски Алманах на Република Македонија*. Комисија за односи со верските заедници.
- Котевска, Б. (2013). *Водич за основи за дискриминација*. Мисијата на ОБСЕ во Скопје.
- Кочовски, М. (2013). *Меѓународни организации и интеграции*. Универзитет „Гоце Делчев“ – Штип.
- Линк, Т. (2000). *Историја религије истока и запада*. Српска књижевна задруга.
- Лукиќ, Р. (1982). *Социологија морала*. Научна књига.
- Македонска академија на науките и уметностите. (1995). *Социолошки термилошки речник*. Македонска академија на науките и уметностите.
- Мисија на ОБСЕ во Скопје. (2010). *Возраст, контакт, перцепции – Како училиштата ги оформуваат релациите помеѓу етничките заедници*. Мисија на ОБСЕ во Скопје.
- Мисија на ОБСЕ во Скопје. (2011). *Прирачник, Социјални вештини и одговорности на наставници и стручни соработници во училиштето*. Мисија на ОБСЕ во Скопје.
- Митрова, К., Низамовски, Д., Поповска, Т., Марковска, А., Калевска, Ф., Кочковска, К., Божовиќ, С. И Анастасовска, С. (2015). *Учиме право, учебник за граѓански и политички слободи и права*. Младински образовен форум.
- Мицковска Г., Чешларов М. и Мицковска-Ралева А. (2016). *Реализација на наставата по граѓанско образование во основните училишта – Извештај од испитувањето*. Македонски центар за граѓанско образование.
- Негриевска, Ф., Балажи, С., Николоски-Алушески, С. и Дедова, Р. (2009). *Прирачник за образование за животни вештини за VII-IX одделение*. Биро за развој на образованието. (достапно на: <http://umd.gov.mk/wp-content/uploads/2013/10/Priracnik-za-obrazovanie-za-zivotni-vestini-od-VII-do-IX-oddelenie.pdf>)
- Организација на обединетите нации (ООН). (1948). *Универзалната декларација за човекови права*. Организација на обединетите нации (ООН). (достапно на: <http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>)
- Павичевич, В. (1974). *Основи етике*. БИГЗ.
- Петроска-Бешка, В. (1995). *Конфликти: што претставуваат и како се разрешуваат*. Филозофски факултет.
- Петроска-Бешка, В. и Најчевска, М. (2018). *Од етнички до граѓански национализам преку основното образование*. Центар за човекови права и разрешување конфликти.
- Петроска-Бешка, В., Дедова, Р., Негриевска, Ф., Балажи, С. и Николоски-Алушески, С. (2011). *Образование за животни вештини, прирачник за наставници од средните училишта*. Биро за развој на образованието.
- Реџеџи, З. (2011). *Обединета Европа од идеја до реализација*. АРС-33 Тетово.
- Сеќавање во движење, педагошка алатка за културата на сеќавање, прирачник, 2016, ЗФД Форум, Сараево.
- Тејлор, Ч. (2004). *Мултикултурализам – Огледи за политиката на признавање*. Евро Балкан Пресс.

- Фрчкоски, Љ. Д., Георгиевски, С., Петрушевска, Т. (2012). *Меѓународно јавно право*. Магор.
- Ценевска, М. (2006). *Компас. Прирачник за образование на младите луѓе за човековите права*. Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ - Скопје
- Шкарик, С. и Силјановска-Давкова, Г. (2009). *Уставно право*. Култура.
- Bojd, E. (2002). *Novinarstvo u elektronskim medijima. Metodi pripreme radio i televizijskih vesti*. Clio.
- Brigs, A. i Berk, P. (2006). *Društvena istorija medija*. Clio.
- Dačić, S. (2006). *Sociologija religije i verska tolerancija, Vo Religija i tolerancija*. Čigoja Štampa.
- Dardić, D. i Milojević, M. (2010). *Priručnik za izvještavanje o marginalizovanim grupama*. Grafid.
- Eko, U. (1973). *Kultura, Informacija, Komunikacija*. Nolit.
- Elijade, M. (1996). *Vodič kroz svetske religije*. Narodna knjiga Alfa.
- Forumi QHSD (2014). *Doracak për qytetari aktive*. Shkolla për qytetari aktive, Forumi QHSD.
- Giddens, A. (2001). *Sociology*. Polity Press in association of Blackwell Publishers a Blackwell Publishing Company.
- Griffiths, R. (1998). *Video journalism*. Focal Press.
- Hamilton, N. (2007). *Analysis-Web Model Not Necessarily Papers Savior*. PR Week.
- Haralambos, M. i Holborn, M. (2002). *Sociološke teme i perspektive*. Golden marketing.
- Janković, J. (2004). *Savjetovanje u psihosocijalnom radu*. Nacionalna Sveučilišna knjižnica.
- Joksimović, S. (2003). *Odnos mladih prema pripadnicima pojedinih društvenih grupa i verskih zajednica*. Institut za pedagoška istraživanja.
- Koković, D. (2007). *Društvo i medijski izazovi. Uvod u sociologiju masovnih komunikacija*. Novi Filozofski fakultet – Odsek za medijske studije.
- Pavičević, V. (1986). *Sociologija religije-sa elementima filozofije religije*. BIGZ.
- Peoples, J. and Cengage, G.B. (2009). *Humanity: An Introduction to Cultural Anthropology*. Cengage Learning.
- Price, S. (1994). *Media Studies*. Pitman Publishing.
- Qendra për bashkëpunim ballkanik „LOJA“. (2015). *Manual për multikulturalizëm*. Qendra për bashkëpunim ballkanik „LOJA“.
- Read, D. (1992). *The Power of News: The Story of Reuters*. Oxford.
- Suhler-Stivenson, V. (2006). *Communications Industry Forecast*. Veronis Suhler Stevenson.

- Šušnjič, Đ. (1997). *Dijalog i tolerancija*. Čigoja Štampa.
- Tadić, Lj. (1987). *Ogledi o javnosti*. Univerzitetna riječ.
- Temkov, K. (2003). *Etika za mlade*. Bajka.
- Tjurou, Dž. (2013). *Mediji danas. Uvod u masovne komunikacije I*. Clio.
- Tjurou, Dž. (2013). *Mediji danas. Uvod u masovne komunikacije II*. Clio.
- Tomić, Z. (2003). *Komunikologija*. Čigoja.
- United Nations New York and Geneva. (2004). *Teaching Human Rights. Practical activities for primary and secondary schools*. United Nations New York and Geneva.
- Vernon, M.G. (1962). *Sociology of Religion*. McGraw, Hillbook Company.
- Žižak, A. ur. (2009). *Izazovi grupnog rada s djecom, mladima i odraslima u riziku*. Edukacijsko-rehabilitacijski fakultet.





